




“PËR RAPORTIMIN E SITUATËS SË DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE GJATË COVID-19”

RAPORT KOMBËTAR

KORRIK 2020

Ky raport është realizuar mbështetur në informacionet e përfituara nga Komisionet e Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale në 48 Bashki në Shqipëri, në kuadër të procesit të monitorimit të punës së Bashkisë, si një nga kompetencat e Këshillave Bashkiakë.

Ky informacion është siguruar me mbështetjen e ekspertëve të Bashkisë së Fortë, me qëllimin për të analizuar dhe kuptuar situatën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, gjatë situatës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19.

Ky raport është një praktikë pune e vazhdueshme e Komisioneve të Barazisë Gjinore dhe të Përfshirjes Sociale dhe përmbajtja e tij nuk duhet të trajtohet si statikë e pandryshueshme. Raporti përmban një përmbledhje të mundësive dhe proceseve për të kuptuar praktikën e mira, të zbatuara gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 në harkun kohor Mars – Qershor 2020, si dhe problematikave që mund të adresohen në muajt në vijim, në bashkëpunim me Aleancën Kombëtare të Grave Këshilltare. Raporti është një dokument pune që do të vazhdojë të përditësohet duke iu përgjigjur zhvillimeve të mëtejshme të gjendjes së Covid-19.

FALENDERIME

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe i Çështjeve gjinore në këshillat bashkiak dhe ekipi i ekspertëve të Bashki të Forta, udhëhequr nga Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje” dhe “Gruaja në Integrim” falënderon të gjithë përfaqësuesit e bashkive dhe institucionet që kontribuan përmes një procesi dinamik në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit.

PARANTEZË

Ky raport u bë i mundur me mbështetjen financiare të ofruar nga “Bashki të Forta”, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nën supervizimin e Znj. Valbona Karakçi, Këshilltare Strategjike e BtF dhe Znj. Arberesha Mushani, Oficere Programi e BtF.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të “Bashki të Forta” dhe të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

SHKURTIMET

MKR - Mekanizmi i Koordinuar i Referimit

ETN - Ekipit Teknik Ndërsektorial

KVDHF - Koordinator(i)ja Vendor(e) për Dhunën në Familje

UMM - Urdhër Mbrojtje

UM – Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje

KB - Këshill Bashkiak

VKB – Vendime të Këshillit Bashkiak

MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

NJA - Njësive Administrative

ZVA - Zyra Vendore Arsimore

SPZ - Specialisti i Policisë së Zonës

VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave

PMF - Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje.....	6
METODOLOGJIA.....	7
GJETJET KRYESORE	8
I. SITUATA E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE GJATË COVID-19	11
II. SHËRBIME TË OFRUARA GJATË COVID-19 PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE	12
III. PRAKTIKA TË MIRA TË NDËRMARRA PËR PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE	17
IV. MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE.....	24
VI. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR KOORDINIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE	57
VII. SUGJERIME PËR KËSHILLAT BASHKIAKË PËR NJË ADRESIM DHE MENAXHIM MË TË MIRË TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE.....	64
ANEKSI 1: FORMAT PERIODIK RAPORTIMI MBI SITUATËN E DHUNËS GJATË SITUATËS COVID-19.....	85
ANEKSI 2: UDHËZUESI I FOKUS GRUPIT ME AKTORËT KYÇ VENDORË.....	87

Hyrje

Dhuna me bazë gjinore, dhe veçanërisht dhuna në familje, përshkallëzohet në kushtet kur ekziston një situatë krize apo emergjence dhe situata e krijuar për shkak të pandemisë Covid-19, përbën një rrezik të shtuar për dhunën në familje.

Kushtet e distancimit fizik dhe shoqëror që u vendosën në Shqipëri për të shmangur përhapjen e virusit Covid-19, sollën si rrjedhojë përballjen e grave dhe vajzave me dhunë të shtuar në marrëdhëniet familjare, në kushtet e izolimit të plotë dhe pamundësisë për ndihmë.

Në kushtet e izolimit nga COVID-19, përjetimi i dhunës në familje përkeqësohet nga faktorë të tillë si stresi emocional i vazhdueshëm, turrja e ekonomisë familjare si dhe ndryshimi i roleve dhe përgjegjësitë midis anëtarëve të familjes. Kur këta faktorë kombinohen me njëra-tjetrën dhe gërshetohen me kufizime të tjera të lëvizjes, shtëpia mund të kthehet në një mjedis me rrisht të rritur dhune, ku dhunuesit mund të përshkallëzojnë dhunën, ndërsa të mbijetuarit kanë mundësi të kufizuara për të kërkuar ndihmë.

Duke konsideruar kushtet e izolimit për shkak të COVID-19 dhe duke kuptuar që pandemia intensifikon pabarazitë ekzistuese të të drejtave midis grave dhe burrave dhe grupeve të ndryshme sociale, me nismë të Komisioneve të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, me mbështetjen e Bashki të Forta, këshillat bashkiakë të 45 bashkive në Shqipëri ndërmorrën dhe miratuan Rezolutën “Mbi marrjen e masave të veçanta për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga Covid-19.”

Miratimi i Rezolutës erdhi si nevojë e menjëhershme për t’iu përgjigjur dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Rezoluta synon të rrisë eficientësinë e strukturave dhe burimeve ekzistuese përkatëse në territorin e Bashkisë, për të parandaluar dhe për të marrë në mbrojtje viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës në familje.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të kësaj rezolute, raporti nga ana e Komisioneve Gjinore dhe Përfshirjes Sociale **“Për raportimin e situatës së dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore gjatë Covid-19”** është realizuar për të analizuar dhe krahasuar të dhënat e rasteve të dhunës në familje dhe paraqet të dhëna dhe informacione për të kuptuar nevojat e identifikuar dhe marrjen e masave në nivel vendimarrës për adresimin dhe trajtimin e dhunës në familje në 48 Bashki të Shqipërisë.

Ky raport shërben, gjithashtu, për të kuptuar nivelin e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm në punën për adresimin e rasteve të dhunës në familje gjatë dhe post Covid-19.

METODOLOGJIA

Informacioni i paraqitur në këtë raport përfshin të dhëna që 48 Komisione të Barazisë Gjinore dhe të Përfshirjes Sociale kanë marrë nga burime të ndryshme, administrata e Bashkisë dhe grupet e interesit, për të kuptuar situatën e dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore gjatë periudhës Mars – Maj 2020.

Metoda e punës për hartimin e këtij raporti është mbështetur në dy shtylla kryesore: i) Të dhënat bazë të prodhuara nga administratat e bashkive të përfshira në këtë raport dhe ii) Të dhënat bazë të përfituara nga takimet me fokus grupe, grupet e interesit dhe përfituesit e shërbimeve.


Komisionet e Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale në bashkitë respektive kanë mbledhur informacionin bazë nga administrata e Bashkisë mbi masat e marra dhe shërbimet e ofruara gjatë kushteve të izolimit nga COVID-19 nëpërmjet një raporti periodik që përgatitet nga strukturat përgjegjëse në Bashki. Përmes raporteve periodike, anëtarët e komisioneve të barazisë gjinore kanë vlerësuar rastet e dhunës në familje gjatë periudhës së izolimit të shkaktuar nga Covid-19 dhe kanë identifikuar nevojat për marrjen e masave në nivel vendimmarrës. Në total janë përgatitur 48 raporte periodike.

Komisionet e Barazisë Gjinore dhe Përkrahjes Sociale, si burim të dytë informacioni kanë siguruar të dhëna nga takimet e organizuara me fokus grupe, grupet e interesit dhe me përfitues të shërbimeve. Në total janë realizuar 48 takime me fokus grupe dhe grupet e interesit në secilën nga 45 Bashkitë për të cilat është hartuar ky raport.



Në vijim, paraqiten të dhëna dhe informacione përmbledhëse lidhur me zbatimin e rezolutës për të 48 Bashkitë, masat e ndërmarra dhe bashkëpunimi ndërinstytucional, nevojat dhe sfidat e hasura, praktika inovative, si edhe rekomandime për Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak, për një adresim më efektiv të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

- Cilat janë shërbimet kryesore që u ofruan bashkitë për trajtimin e dhunës në familje gjatë Covid-19?**



Grafik 1: Të dhëna për shërbimet kryesore që u ofruan bashkitë për trajtimin e dhunës në familje gjatë Covid-19

Tre llojet e shërbimeve që u janë ofruar viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje, më së shumti, në secilën prej 48 bashkive që kanë qenë pjesë e raportit, janë: paketa ekonomike (duke përfshirë paketa ushqimore, medikamente dhe produkte higjeno-sanitare), këshillimi e mbështetja psikologjike, si dhe mbështetja ligjore.

Viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës në familje janë mbështur me strehim duke përfutur shërbime në lidhje me subvencionimin e qirasë, mbulimin e shpenzimeve për ujë dhe dritat, strehim të përkohshëm në qendrat e emergjencës për rastet e dhunës dhe strehim në banesa sociale.


Për ndjekjen e rasteve të dhunës, por edhe për denocimin e dhunës, janë vënë në dispozicion linja telefonike për këshillim psikologjik në ato raste kur nuk ka qenë i mundur apo emergjent kontakti personal me viktimat e dhunës. Shërbimet psikologjike janë realizuar edhe në bashkëpunim me organizata lokale që punojnë për çështjet e dhunës në familje.

Rastet e dhunës të denoncuar gjatë Covid-19, dhe ato raste që kanë qenë në menaxhim, kanë marrë shërbime të mbështetjes ligjore në të gjitha bashkitë.

Ndërkaq, viktimat dhe të mbijetuarit/at e dhunës në familje janë mbështetur në 5 Bashki me shërbime të formimit profesional dhe të punësimit nëpërmjet kurseve të formimit profesional apo mundësi punësimi në bashkëpunim me zyrat e punës dhe me bizneset lokale.

Viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës në familje, janë asistuar në 13 bashki nga 48 bashkitë e analizuara në të cilat janë ofruar shërbime të tilla si: shoqërim për ndihmë mjekësore dhe blerje të medikamenteve të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës seksuale në bashkëpunim me spitalin zonal dhe policinë.

Të gjitha bashkitë i kanë kushtuar vëmendje të veçantë informimit të publikut për rreziqet e



shtuara të dhunës në familje gjatë periudhës së Covid-19. Në faqet zyrtare të Bashkive, si dhe në mediat sociale të bashkive janë vënë në dispozicion 24 orë numra telefoni për të raportuar rastet e dhunës në familje, si dhe në disa raste broshura ndërgjegjëse.

Përafërsisht rreth 11,716.529 Lekë janë alokuar nga bashkitë për t'iu përgjigjur me shërbime rasteve të dhunës në familje gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.

- **Cilat janë sfidat më të cilat u përballën bashkitë për trajtimin e dhunës në familje gjatë Covid-19?**

Mbështetur në raportet periodike të administratës së bashkive për të cilat është prodhuar ky raport, sfidat kryesore me të cilat janë përballur bashkitë janë:

- Mungesë në burime njerëzore për punonjës socialë dhe psikologë** në administratë dhe në njësitë administrative.
- Mungesë të buxhetit të dedikuar** për manaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Ruajtja e të dhënave personale** të rasteve të dhunës në familje, e cila çon në shkallë më të lartë të rrezikshmërisë për viktimat apo tërheqjen e denoncimeve.
- Mungesa e një sistemi logjistik për transport** për punonjësit e shërbimeve si dhe për viktimat/të mbijetuarit drejt institucioneve apo drejt një vendi më të sigurt.
- Mungesa e qendrave të emergjencës për rastet** e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Mungesa e banesave ose shtëpive sociale** për rastet dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Vështirësi në identifikimin në faza të hershme të rasteve të dhunës** për shkak të mos funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.
- Programet dhe shërbimet e ofruara nga institucionet janë kryesisht programe mbështetëse** dhe jo programe për ri-integrimin e të mbijetuarve të dhunës.

- ix. **Hezitimi për të denoncuar dhunën dhe tërheqja denoncimeve për rastet e dhunës** për shkak të mendësisë për të toleruar dhunën, publikimit të të dhënave personale, varësisë ekonomike, druajtjes nga paragjykimet e shoqërisë.

Rekomandime për Bashkitë në kuadër të përmirësimit të shërbimit kundrejt rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore:

Me qëllimin për të përmirësuar shërbimet ndaj dhunës në familje apo jashtë saj, janë identifikuar disa rekomandime në bashkitë e përfshira në këtë raport si më poshtë:

42% sugjerojnë ngritjen e një qendre multifunkionale

Në 42% të bashkive është sugjeruar ngritja dhe funksionimi i një qendre multifunkionale për të trajtuar rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

58% sugjerojnë organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe informuese

Në 58% të bashkive është sugjeruar organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe informuese për të parandaluar dhe t'i dhënë fund dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

21% sugjerojnë alokim fondi për transport.

Në 21% të bashkive është sugjeruar alokim fondi për transportin në kuadër të shërbimeve për dhunën në familje për të mbuluar edhe njësitë administrative të bashkisë.

69% sugjerojnë shtim të stafit të kualifikuar.

Në 69% të bashkive është sugjeruar rritja e numrit të të punësuarve si: punonjës socialë, psikologë dhe administratorë socialë për ofrimin e shërbimeve sociale në bashki dhe në njësitë administrative.

27% sugjeruan ngritjen e qendrave emergjente.

Në 27% të bashkive është sugjeruar ngritja e qendrave emergjente akomoduese për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

58% sugjerojnë alokim buxheti për menaxhimin e rasteve të dhunës.


Në 58% të bashkive është sugjeruar alokim i veçantë në buxhet për menaxhimin e rasteve të dhunës.

58% sugjerojnë krijimi i programeve re-intreguese .


Në 58% të bashkive është sugjeruar krijimi i programeve re-intreguese për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë strategji punësimi, aftësim profesional dhe mbështetje financiare.

I. SITUATA E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE GJATË COVID-19


Përgjatë izolimit të pandemisë Covid-19, bashkitë janë mobilizuar për të dhënë shërbime për rastet e dhunës në familje të raportuara gjatë kësaj periudhe, si dhe për të ndjekur rastet dhunës në familje përpara Covid-19. Edhe pse disa shërbime janë kryer në distancë, nëpërmjet komunikimit online, është bërë e mundur që të organizohen takime të grupeve të punës, të ofrohen shërbime të ndihmës ekonomike, shërbime të strehimit, si dhe në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm bashkitë kanë mundur të realizimin e shërbimeve ligjore, psikologjike, shëndetësore dhe të formimit profesional dhe të punësimit. Në grafikun e mëposhtëm është prezantuar numri i rasteve të denoncuar gjatë viteve 2019 dhe 2020.



Grafik 2: Diferenca e raportimeve të rasteve të dhunë krahasuar midis vitit 2020 dhe 2019



Grafik 3: Të dhëna për rastet e denoncuar të dhunës në familje në vitin 2020



Grafik 4: Të dhëna për rastet e denoncuar të dhunës në familje në vitin 2019

II. SHËRBIME TË OFRUARA GJATË COVID-19 PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19, kujdesi i punonjësve të dhunës në familje qenë i shtuar. Bashkitë kanë ofruar shërbime të ndryshme për t'iu ardhur në ndihmë të mbijetuarve të dhunës në familje dhe të dhunës në familje, sipas nevojave specifike që janë paraqitur.

2.1 Shërbime sociale



2.1.1 Strehimi i rasteve të dhunës në familje

Bashkia Gramsh ka ofruar bonuse qeraje deri në dy vite për të mbijetuarit e dhunës në familje.

Bashkia Klos ka të miratuar fond për të mbuluar strehimin e personave të pastrehë ku përfshihen edhe viktimat e dhunës në familje nëse janë në kushte të mungesës të strehimit.

Bashkia Korçë ka një fond për gratë e dhunuara për të mbuluar shpenzimet e qera, ujit, dhe dritave.

Gjithashtu, **Bashkia Poliçan** ka bërë të mundur strehim të përkohshëm për rastet e dhunës në familje.

Bashkia Mirditë ka vendosur në dispozicion mjedise si shërbim emergjence për rastet e dhunës.

Në **Bashkinë Pogradec** dy raste të dhunës në familje, të cilat kanë marrë urdhër mbrojtje, janë adresuar tek qendra e emergjencës 2 ditore ku dhe është ofruar shërbimi psikologjik.

Për rastet me të cilat ka qenë e mundur të sigurohen kontaktet dhe të komunikohet, është ofruar mbështetje dhe këshillim nga zyra e shërbimeve sociale pranë **Bashkisë Shijak**.

Po ashtu **Bashkia Vlorë** ka trajtuar me bonus qeraje rastet e dhunës në familje.

Bashkia Rrogozhinë ka rikonstruktuar dhe mobiluar banesën për 2 minorenë që janë viktime të dhunës në familje si edhe iu ka akorduar një pagë mujore.

Në **Bashkinë Kamëz** janë referuar dy raste tek Drejtoria e Çështjeve të Strehimit për përfitim të bonusit të qerasë dhe një rast tek organizatat lokale.

Bashkia Kolonjë ka alokuar një bonus qeraje për 1 rast të dhunës në familje dhe kujdes për fëmijët duke i regjistruar në kopësht.

Bashkia Devoll ka ofruar subvencionimin e qirasë për rastet e dhunës në familje.

Në **Bashkinë Fier** ka ofruar bonus për qeratë nga ana e Bashkisë në ndihmë të gjithë viktimave/ të mbijetuarve me Urdhër Mbrojtje dhe duke u venë në dispozicion banesë me qera me kosto minimale.

Bashkia Cërrik ka ofruar bonus qeraje nga ana e Bashkisë në ndihmë të viktimave/ të mbijetuarve dhe ka vijuar mbështetjen me kreditë e buta për banesë.

2.1.2 Mbështetja ekonomike



Rasteve të dhunës në familje u është ofruar mbështetje nëpërmjet paketave ekonomike duke përfshirë paketa ushqimore, medikamente dhe produkte higjeno-sanitare. Ndër disa nga bashkitë mund të përmendim:

Fokusi në **Bashkinë Belsh** ka qenë, kryesisht, në shpërndarjen e ndihmës ekonomike, pakove ushqimore dhe veshmbathjeve, të cilat janë dhuruar dhe ofruar nga donatorët. Bashkia i ka kushtuar vëmendje të plotë koordinimit dhe shpërndarjes së ndihmave për kategoritë në nevojë për rastet e dhunës në familje, familjet e varfra, të moshuarit, dhe tetraplegjikët.

Bashkia Elbasan ka ofruar 45 pako ushqimore dhe sanitare për viktimat e dhunës në familje përgjatë situatës pandemike. Po ashtu, për rastet e reja të pajisur me UM gjatë kësaj periudhe është ofruar aplikimi online nga Koordinatorja Vendore për ndihmën ekonomike.

Bashkia Peqin nga fondi i saj si dhe në bashkëpunim me bizneset kanë ofruar paketa ushqimore për rastet e dhunës në familje dhe për personat me gjendje ekonomike të ulët. Për secilin rast dhune me urdhër mbrojtje, shërbimi social ka ofruar një fond prej 3,000 Lek.

Në **Bashkinë Korçë** është bërë e mundur shpërndarja e paketave ushqimore dhe higjeno-sanitare. Shoqëria civile dhe aktorë të tjerë u përqendruan më shumë në koordinimin dhe shpërndarjen e paketave ushqimore. Në bashkëpunim edhe me donatorë si UNICEF u shpërndanë rreth 144 paketave ushqimore dhe higjeno-sanitare. Janë mbështetur 20 gra të dhunuara me paketa ushqimore. Po ashtu, ndihma ekonomike nga 3,000 lek që është normalisht u dyfishua për këtë periudhë me vendim të këshillit bashkiak duke përfituar pesë (5) raste.

Në **Bashkinë Shijak** është ngritur struktura e Emergjencave Civile në kushtet e pandemisë, për ndarjen e pakove ushqimore dhe medikamenteve nga të ardhurat e Bashkisë, fondacioneve të ndryshme dhe nga emergjencat e shtetit, për personat që trajtohen me ndihme ekonomike, familjet në nevojë dhe ata të pajisur me urdhra mbrojtje.

Bashkia Mallakastër ka mbështetur me ndihma ushqimore si edhe me paketë ekonomike katër rastet e dhunës në familje.

Nga koordinatorja vendore e dhunës në **Bashkinë Pustec** është verifikuar situata ekonomike dhe janë dhënë pako ushqimore përmes fondit të emergjencës së Bashkisë dhe i është alokuar një pagesë mujore prej 3.000 lekë/muaj.

Në **Bashkinë Shkodër** në rastet e nevojshme pas vlerësimit të situatës dhe nevojave është realizuar mbështetja e rasteve me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare.

Gjithashtu, **Bashkia Klos** ka dhënë paketa ekonomike: paketa ushqimore për gjashtë viktimat të dhunës në familje të vitit 2019 dhe dy viktimat të dhunës në familje të vitit 2020. Në bashkëpunim edhe me donatorë si UNICEF janë mbështetur 20 gra të dhunuara me paketa ushqimore dhe higjeno-sanitare.

Bashkia Kolonjë përmes zyrës së punës ka bërë të mundur punësimin për rastet e dhunës në familje.

Bashkia Kukës ka kryer shërbimin e pagesës tek ndihma ekonomike për viktimën për rastet me urdhër mbrojtje.

Të mbijetuarit e dhunës në familje dhe familjet e pajisura me UM/UMM janë mbështetur me paketa ushqimore nga **Bashkia Gjirokastrë**.

Po ashtu, **Bashkia Malësi e Madhe** ka shpërndarë pako me ndihma ushqimore familjeve në nevojë që njëkohësisht janë edhe familje viktimë e dhunës.

Bashkia Lezhë në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka bërë të mundur pajisjen me pako ushqimore për viktimat e dhunës në familje.

Bashkia Këlcyrë ka dhënë mbështetje me paketa ekonomike për rastet e dhunës në familje.

Në **Bashkinë Pogradec** gjatë periudhës së Covid-19 nga ana e strukturave të bashkisë, shërbimit social në bashkepunim me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve janë kontaktuar viktimat e dhunës në familje dhe është mundësuar ndihma me 100 kite ushqimore dhe higjienike për këto familje.

Bashkia Cërrik ka shpërndarë paketa ushqimore dhe sanitare për rastet e dhunës në familje disa herë gjatë periudhës COVID-19, si dhe ka integruar në sistemin e ndihmës ekonomike të viktimat/të mbijetuarat e dhunës.

2.2 Shërbime të mbështetjes psikologjike



Gjatë periudhës së Covid-19, janë shërbime të mbështetjes psikologjike duke kryer vizita në terren si edhe këshillim psikologjik on-line. Ndër disa nga bashkitë mund të përmendim:

Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në **Bashkinë Shkodër**.

Bashkia Këlcyrë ka vënë në dispozicion numrin telefonik të koordinatores vendore, për të ofruar këshillim online.

Bashkia Roskovec ka ofruar shërbime të mbështetjes psikologjike (online) për 35 raste të dhunës në familje, nga të cilat 5 raste gjatë pandemisë Covid-19.

Në **Bashkinë Maliq**, KVDHF ndan informacion të vazhdueshëm me DAR/ZA në lidhje me rastet e identifikuara të fëmijëve të përballur me dhunë të drejtpërdrejtë ose të asistuar në familje. DAR/ZA po ashtu luajnë rol aktiv përmes vënies në dispozicion të fëmijëve të dhunuar të shërbimit të psikologëve në shkollë. Ky shërbim u ofrohet fëmijëve nëpërmjet telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit on-line nga psikologët e shkollave.

Bashkia Belsh së bashku me organizata jo fitimprurëse bashkëpunojnë për të informuar komunitetin për praninë e shërbimeve psikologjike ose ligjore në rast se përjetojnë dhunë.

Bashkia Kamëz ka bashkëpunuar me psikologët shkollorë për fëmijët e viktimave të dhunës në familje, po ashtu 1 rast i dhunës në familje është referuar organizata

Bashkia Dropull për të vetmin rast të pritur ka ofruar shërbim të këshillimit psikologjik (online), informim dhe referim në shërbime të tjera të specializuara.

Bashkia Mirditë ka ofruar këshillim psikologjik nëpërmjet linjës telefonike nga punonjësit e shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje.

Në **Bashkinë Pogradec** është në funksion numri i telefonit pa pagesë për linjën e këshillimit, shërbimit psikologjik, takime ballë për ballë, që përveç nga Bashkia ofrohen edhe nga organizatat jofitimprurëse.

2.3 Shërbime të mbështetjes ligjore



Të gjitha bashkitë kanë asistuar rastet e dhunës në familje duke dhënë informacion mbi të gjitha parashikimet ligjore dhe për ndjekjen e rasteve të dhunës në familje. Në të gjitha rastet e

denoncuara për dhunë në familje, KV ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë për të dhënë asistencën ligjore si dhe për lëshimin e UMM-ve dhe UM-ve, po ashtu në disa raste edhe me organizata jo fitimprurëse për këshillimin dhe shërbim ligjor falas.

Bashkitë kanë bashkëpunuar ngushtësisht me strukturat e Policisë, Prokurorinë dhe Gjykatat për të marrë në shqyrtim rastet e dhunës në familje dhe lëshimin dhe vërtetimin e UM-ve dhe UMM-ve.

2.4 Shërbime të formimit profesional dhe të punësimit



Bashkia Kukës dhe **Bashkia Gramsh** kanë referuar rastet e dhunës në familje tek zyra e punës për dhënien e mundësive për punësim apo trajnim profesional.

Bashkia Maliq për rastet e trajtuara në mbledhjen on line të ETN-së ka diskutuar edhe mbi një plan pas COVID-19 për mbështetjen e rasteve të dhunës në familje me kurse formimi profesional apo mundësi punësimi. KVDHF informon në vazhdimësi Zyrën e Punës për rastet e dhunës në familje, me qëllim përfshirjen e tyre në listat për formimin profesional dhe punësim.

Bashkia Kamëz ka referuar 4 raste të dhunës në familje tek Zyra e Punës për mundësi punësimi.

Bashkia Fier në bashkëpunim me pastiçerinë 'Che Buono' në Fier ka ofruar kurse falas gatimi për të gjitha gratë e dhunuara që janë me urdhra mbrojtje.

2.5 Shërbime shëndetësore



Bashkia Memaliaj ka realizuar shoqërim për ndihmë mjekësore dhe blerje të medikamenteve, si dhe trajtim për shëndetin mendor, në bashkëpunim me spitalin zonal dhe policinë.

Në **Bashkinë Këlcyrë** është shoqëruar 1 rast i dhunës seksuale nga punonjës të shëndetit mendor zonal dhe psikologjia e zyrës arsimore lokale për ndihmë mjekësore dhe për trajtim psikologjik në spital psikiatrik.

Po ashtu në **Bashkinë Mallakastër** është kryer shoqërim për ndihmë mjekësore të shëndetit mendor për 1 rast të dhunës në familje. Rasti është ndjekur me trajtim online me psikolog të vendosur nga Bashkia.

Në **Bashkinë Elbasan** rastet e dhunës janë asistuar me kujdes shëndetësor dhe rimbursim të recetave për fëmijët.

2.6 Veprimtari ndërgjegjëse dhe informuese:



Të gjitha bashkitë i kanë kushtuar vëmendje të veçantë informimit të publikut lidhur me rreziqet e shtuara të dhunës në familje gjatë Covid-19 dhe mënyrat e kontaktimit për të raportuar dhunën.

Në faqet zyrtare të Bashkive, si dhe në median e tyre sociale, gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, bashkitë kanë vënë në dispozicion 24 orë numra telefoni për të raportuar rastet e dhunës në familje, si dhe broshura informuese për dhunën dhe reagimin ndaj saj.

III. PRAKTIKA TË MIRA TË NDËRMARRA PËR PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Një nga masat më të rëndësishme për të parandaluar dhe luftuar dhunën është bashkëpunimi i autoriteteve vendore me organizatat e shoqërisë civile si dhe siguri i mbështetjes së vazhdueshme financiare. Nga të dhënat dhe raportimet e Komisioneve të Barazisë Gjinore dhe Përkrahjes Sociale janë identifikuar raste me impakt pozitiv në reduktimin e rasteve të dhunës si dhe zgjidhje të problematikave përmes ndërhyrjes të cilat janë prezantuar si Praktika të Mira Menaxhuese dhe i referohen bashkive si më poshtë:

Bashkia Belsh për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ka marrë ndihmë kryesore nga organizata e shoqërisë civile “Forumi i Gruas në Elbasan”, duke referuar të gjitha rastet e dhunës në këtë Bashki tek kjo organizatë. Falë këtij bashkëpunimit, kjo organizatë i ka mundësuar Bashkisë Belsh:

- *Shërbim psikologjik*: një psikologe e punësuar part time do të mbështetet për pothuaj një vit nga Forumi i Gruas në Elbasan. Kjo ndihmë bën të mundur që rastet të mos dërgohen më në Elbasan, por mund të trajtohen në Belsh.
- *Shërbim ligjor*: Forumi ka angazhuar një avokat me kohë të plotë që do të mbulojë ekskluzivisht vetëm shqetësimet dhe monitorimin e rasteve që kanë marrë Urdhër Mbrojtjeje në të gjithë qarkun e Elbasanit.

Për të trajtuar rastet e dhunës në familje në **Bashkinë Delvinë** gjatë pandemisë Covid-19 si dhe për të identifikuar rastet e dhunës janë në dispozicion:

- *Shërbime për raportimin e dhunës në situatë emergjence* – është vënë në dispozicion 24 orë numri i telefonit të shërbimeve sociale në Bashki për të raportuar rastet e dhunës.

Në përgjigje të rasteve të dhunës në familje gjatë Covid-19, **Bashkia Maliq** ka ndërmarrë nismat e mëposhtme:

- *Funksionimin e qendrës multifunksionale* financuar nga UNDP, duke ofruar ndihmë ekonomike, strehim, ndihmë psiko-sociale dhe programme ri-integrimi.
- *Shërbime të mbështetjes psiko-sociale, integrimin dhe strehimin për personat e dhunuar* nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe OJF-të.
- *Mbështetje psiko-sociale dhe ndihma ekonomike* ofruar nga “UNICEF” në kohën e pandemisë, si: dezinfektantë dhe pajisje të tjera për përballimin e situatës.

Bashkia Elbasan i ka dhënë vëmendje të veçantë aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjëse. Këto fushata përfshijnë një sërë aktivitesh sensibilizuese që adresojnë çështjet e dhunës me bazë gjinore të organizuara nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucionet lokale dhe shoqërië civile.

- *Informacion rreth dhunës në familje gjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga Covid-19*: Bashkia Elbasan ka shpërndarë informacion online në faqen zyrtare të internetit, facebook, median lokale ka shpërndarë mesazhe kundër dhunës në familje, si dhe ku mund të kërkohet ndihmë duke vënë në dispozicion kontaktet e nevojshme si të Koordinatorës Vendore, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Policisë dhe Psikologut.
- *Nismëtare e fushatës “Familja për Familjen”*: Bashkia Elbasan ka qenë nismëtare e fushatës mbështetëse “Familja për Familjen” për familjet në nevojë dhe grave të dhunuara.

Bashkia Roskovec për t’iu përgjigjur dhe për të trajtuar rastet e dhunës në familje ka ndërmarrë disa nisma:

- *Bashkëpunim me shërbimet arsimore*. Shërbimet arsimore shpeshherë kanë identifikuar dhe referuar raste tek koordinatori vendore kundër dhunës në familje dhe punonjësja për mbrojtjen e fëmijëve, të cilat pastaj kanë marrë nën shqyrtim situatat përkatëse.
- *Kontakt i vazhdueshëm*. Koordinatorja Vendore kundër Dhunës në Familje ka realizuar postime në rrjetet sociale të Bashkisë dhe ka vënë në dispozicion numrin personal,

numrin e policisë dhe numrin e linjës së shërbimit për vajza dhe gra për të informuar qytetarët për ofrimin e shërbimeve edhe gjatë situatës së pandemisë.

- *Ndërgjegjësim dhe informim.* Janë shpërndarë fletëpalosje për ndërgjegjësimin ndaj dhunës në familje.
- *Bashkëpunimi me shërbimet e gjyqësorit.* Shërbimet e gjyqësorit kanë realizuar akordim të Urdhërit të Mbrojtjes për pesë raste gjatë pandemisë.

Në **Bashkinë Patos**, përgjatë muajve prill-qershor 2020, janë organizuar fushata sensibilizuese me të rinjtë në formën e konkurseve online dhe garime sportive për të rritur informimin për dhunën në familje në kohë pandemie.

Bashkia Dropull ka ndërmarrë disa praktika për adresimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në kushtet e pandemisë COVID-19:

- *Protolle për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.* Protokoli i përgatitur dhe dërguar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga anëtarët e MKR-së, si në kushte normale dhe në kushtet e pandemisë COVID-19, është ndarë paraprakisht me të gjithë anëtarët e MKR-së Dropull për miratimin i tij në mbledhjen e radhës së Komitetit Drejtues të këtij mekanizmi. Koordinatorja Vendore kundër Dhunës në Familje është trajnuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UNDP lidhur me zbatimin e këtij protokoli.
- *Informim për raportimin e rasteve të dhunës në familje.* Numrat që janë dispozicion të komunitetit gjatë situatës së COVID-19 janë bërë të njohur edhe në një njoftim të publikuar në faqen e internetit të Bashkisë ku është theksuar rëndësia e denoncimit të rasteve, sidomos në kushtet e izolimit për shkak të pandemisë COVID-19. Në faqen e Facebook të bashkisë janë ndarë, gjithashtu, vazhdimisht edhe video apo postime të MSHMS-së të përgatitura për dhunën në familje dhe trajtimin e saj gjatë kushteve të kufizimit për shkak të COVID-19.

Bashkia Vlorë mbështet financiarisht Qendrën "Vatra" dhe nëpërmjet një marrëveshjeje me të ofron strehimin e viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje.

Bashkia Kolonjë bashkëpunon me organizatat lokale, që ofrojnë shërbime ligjore falas. Po ashtu, Bashkia *ndihmon viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje me vështirësi ekonomike, përmes bonuseve të qerasë, punësimit nëpërmjet zyrës së punës dhe regjistrimit të fëmijëve në kopsht.*

Në **Bashkinë Shijak** po punohet për ngritjen e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN) për rastet e dhunës në familje dhe së shpejti do të kryhet edhe mbledhja me anëtarët e ETN-së. Organizata me të cilën Bashkia Shijak ka bashkëpunuar edhe gjatë Covid-19 për trajtimin e rasteve të dhunës është "Nisma Për Ndryshim Shoqëror" ARSIS, e specializuar në mbështetjen sociale të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve që janë në vështirësi, rrezik ose situatë

të cënueshme dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Lidhja e kontakteve me organizatat mundëson adresimin e rasteve të dhunës dhe marrjen e shërbimeve që nuk mund të ofrohen nga Bashkia, si: *strehimi emergjent edhe ai afatgjatë, përfshirja e viktimave dhe fëmijëve në qendra ku ata mund të marrin shërbimin psiko-social, mjekësor, etj.*

Në **Bashkinë Finiq:**

- Për një nga rastet është mundësuar *strehim i përkohshëm në mjediset në pronësi të Bashkisë*, të cilat janë ngritur në funksion të mbrojtjes ndaj dhunës në familje.
- *Shërbimi telefonik 24 orë* është vënë në dispozicion të raportimeve të rasteve të dhunës në familje.
- *Ndihma ekonomike* është ofruar për familjet në nevojë dhe viktimat e dhunës në familje.

Bashkia Korçë ka ndërmarrë disa praktika:

- Instalimi i *telefonit falas* (0800 34-34);
- *Ndihmë në ushqim dhe veshje* për rastet e dhunës në familje të ndeshura në praktikë.
- *Nxjitja e partneritetit pushtet lokal* – shoqëri civile (Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve psh “Fondacionin Kenedi, Jezus Krishti për Ballkanin etj”). Bashkëpunimi me Fondacionin “Jezus Krishti për Ballkanin” përmes një projekti të mbështetur nga Bashkia, është vënë në dispozicion një apartament “strehëz emergjente” (1+1) me qëllim strehimin e rasteve emergjente. Kapaciteti i kësaj strehëze është për 2 persona viktimat të dhunës në familje me fëmijët e tyre.
- *Trajtimi i rasteve në mënyrë multidisiplinare* dhe pjesëmarrja e më shumë sesa dy institucioneve në menaxhimin dhe trajtimin e këtyre rasteve.
- Fushata ndërgjegjëse në lidhje me fenomenin dhe punën konkrete që zhvillojnë aktorët, anëtarë të mekanizmit kundër dhunës në familje.

Përgjatë pandemisë Covid-19, në **Bashkinë Memaliaj:**

- *Është vënë në dispozicion 24 orë numri i Koordinatorës Vendore për raportimin e dhunës në situatë emergjente;*
- *Është mbajtur komunikim dhe bashkëpunimi i ngushtë me kryepoleqësinë e fshatrave* për të identifikuar rastet e dhunës në familje.

Bashkia Gjirokastrë ka ndërmarrë disa praktika të reja për të trajtuar rastet e dhunës në familje gjatë Covid-19:

- *Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe mbështetja e vazhdueshme e viktimave të dhunës në familje*, pavarësisht vështirësive fizike të krijuara nga pandemia, ishte mjeti i cili mundësoi mirë menaxhimin e rasteve.

- *Mbështetja me paketa ushqimore/financiare dhe këshillim (kryesisht nëpërmjet telefonit), ndihma juridike edhe gjatë periudhës së pandemisë.*

Bashkia Lushnje vlerëson si praktikë të mirë *komunikimin dhe këshillimin online* si risi për shkak të pamundësisë së takimeve ballë për ballë. Edhe pse në distancë, është arritur këshillimi i personave të kontaktuar.

Në **Bashkinë Këlcyrë** për dy rastet e dhunës (një rast për dhunë seksuale dhe një rast për dhunë në marrëdhënie familjare) të marra në mbrojtje është bashkërenduar puna menjëherë për fillimin e procedurave për urdhërin e mbrojtjes.

- Për *paketat ushqimore* ka patur bashkëfinancim, nga të cilat 75% nga “Linja e Këshillimit për Gra dhe për Vajza” dhe 25% nga Bashkia. Transporti për shpërndarje, ka qenë kontribut financiar i punonjësve të administratës së Bashkisë.
- Angazhimi Bashkisë, ka rezultuar me *punësimin në sektorin privat* të rastit të një gruaje të dhunuar nga bashkëshorti, pranë vendbanimit të saj.
- *Është vënë në dispozicion 24 orë numri i telefonit të Koordinatorës Vendore* për raportimin e dhunës në familje.

Nga ana e **Bashkisë Pogradec** në bashkëpunim me USAID më 28.05.2020, është nënshkruar *Karta Evropiane për Barazinë Gjinore*, e cila pritet të finalizohet në muajin gusht 2020 dhe pritet që të ketë impakt në buxhetin e vitit të ardhshëm. Takimet dhe komunikimi për nënshkrimin e Kartës Evropiane për Barazinë Gjinore kanë filluar në muajin mars 2020. *Linja e këshillimit falas për gratë e dhunuara*, një bashkëpunim midis Bashkisë Pogradec dhe shoqatës “Unë Gruaja”.

Funksionimi i qendrës ditore për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, gjithashtu, është një praktikë e mirë. Në këtë qendër janë siguruar përveç akomodimit edhe këshillimi psikologjik dhe ligjor falas. Gjatë periudhës Mars-Maj janë akomoduar 2 raste.

Praktika të mira në **Bashkinë Gramsh** janë realizuar në bashkëpunim me organizata të tjera vendore:

- Bashkëpunimi me “Forumin e Gruas” në Elbasan, ka bërë të mundur që t’i jepet zgjidhje rasteve të emergjencës për dhunë ndaj grave me *strehim, këshillim psikologjik dhe mbështetje ligjore*.

Bashkia Peqin ka ndërmarrje disa nisma për të menaxhuar rastet e dhunës në familje gjatë Covid-19. *Ndihmë ekonomike:*

- Pavarësisht rasteve të adresuara dhe të identifikuara, nga fondi i Bashkisë dhe nga bizneset, janë ofruar paketa ushqimore si për personat e dhunuar, ashtu edhe për personat me gjendje ekonomike në vështirësi.

- Për secilin rast dhune me urdhër mbrojtje, shërbimi social ka ofruar një fond prej 3,000 Lek.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile:

- Shoqata “Forumi i Gruas” dhe “Tjetër Vizion” kanë ofruar jo vetëm ndihma financiare me ushqime, por edhe strehim 4-5 ditor, kurse falas, paketa ushqimore për familjet në nevojë dhe të dhunuara.

Gjithëpërfshirja:

- Qendra për fëmijët me aftësi të kufizuar ka nisur të funksionojë gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 financuar nga Bashkia, pasi kishte vite që ishte mbyllur.

Nisma të këshilltareve bashkiake:

Anëtarët e Këshillit Bashkiak kanë sugjeruar nisma për të mbështetur gratë në këtë zonë. Anëtarët e Këshillit Bashkiak shprehin përpjekjet që kanë bërë vazhdimisht për të përfshirë në buxhetin e bashkisë:

- *Ndërtimin e një çerdheje dhe të një këndi lojërash për fëmijët.*
- *Krijimin e një qendre multifunksionale për mbështetjen e personave të dhunuar dhe të personave në nevojë ekonomike.*

Disa nga shërbimet kryesore dhe praktikat e mira të ofruara në kuadër të adresimit të dhunës në familje, të ndërmarra nga **Bashkia Cërrik** kanë qenë si në vijim:

- *Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (2020 – 2023)* më qëllim përmbushjen e angazhimit publik zyrtar të Bashkisë Cërrik në lidhje me garantimin e barazisë gjinore në jetën vendore.
- *Krijimi i një linje telefonike (8:00-16:00)* pranë zyrës së shërbimit social në Bashki për denoncimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe për të dhënë informacionin e nevojshëm përsa i përket ndihmës, mbrojtjes dhe shërbimeve mbështetëse të parashikuara për këtë qëllim.
- *Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuere në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare (si USAID) në lidhje me informimin dhe ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje, veçanërisht në periudhën e pandemisë Covid-19.*

Krijimi i një baze të dhënash kombëtare. Një nga praktikat më të mira, e cila është ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe po zbatohet në Bashkinë Cërrik dhe në bashki të tjera të vendit, është krijimi i një baze të dhënash kombëtare përsa i përket menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Në **Bashkinë Kamëz**, koordinatoresha vendore ka qenë prezente pothuajse në çdo shkollë, duke realizuar prezantimin e punës së saj si dhe duke *ndarë informacion mbi dhunën dhe të drejtat e përgjegjësitë e fëmijëve.*

Si praktikë e mirë për **Bashkinë Divjakë** theksohet se gjatë periudhës së Covid-19 është bërë i mundur *trajtimi i rasteve të dhunës në familje online, ndjekja e çdo rasti dhe dhënia e këshillimit online apo përmes telefonit në çdo orë*. Gjithashtu, edhe mbledhja e grupit teknik gjatë pandemisë është mbajtur online në varësi të çdo rasti dhe të çdo nevojë.

Në **Bashkinë Klos**, krahas këshillimit që ofrohet nga koordinatoreja për dhunën në familje, viktimat e dhunës në familje mbështeten edhe me shërbimin e strehimit. Në Bashkinë Klos nuk ka banesa sociale, ndaj është përdorur si praktikë *dhënia e bonusit të qerasë*.

Për të parandaluar dhe për të adresuar rastet e DHF, **Bashkia Mirditë** ka ndërmarrë nismat e mëposhtme:

- *Ndërgjegjësim, këshillim dhe komunikim me komunitetin gjatë periudhës së COVID-19.*
- *Adresim i rasteve pranë drejtorive përkatëse për t'u dhënë zgjidhje rasteve të dhunës në familje.*

Në **Bashkinë Skrapar** pavarësisht se nuk ka patur raste të adresuara dhe të identifikuar, nga fondi i Bashkisë dhe nga bizneset janë ofruar paketa ushqimore për familjet në nevojë. Gjithashtu, në Bashkinë Skrapar ka funksionuar *qendra për fëmijët me aftësi të kufizuar* për të lehtësuar edhe familjet e tyre.

Gjatë periudhës së Covid-19, **Bashkia Përmet** ka ndërmarrë disa nisma për të parandaluar dhe trajtuar rastet e dhunës në familje:

- Në bashkëpunim me psikologët e Zyrës Arsimore lokale ka nisur një *proces ndërgjegjësimi për prandalimin e dhunës në arsimin 9-vjeçar dhe atë mesëm* që prej nisjes së vitit shkollor që ka vijuar online edhe gjatë periudhës së karantinës.
- Kryetarja e KBGJ në Këshillin Bashkiak Përmet, Znj. Elena Mullaraj, e cila aktualisht është edhe lehtësuese e një nisme të Këshillit të Europës për pakicat Egjiptiane në
- Përmet, ka siguruar pajisje mbrojtëse për punëtorët e pastrim gjelbërimit. Si edhe nga bashkëpunimi me grupin komunitar në veprim, *janë mbështetur me paketa ushqimore 30 familje nga të cilat 15 gra të divorcuara, kryefamiljare.*
- *Është vënë në dispozicion 24 orë numri i telefonit të Drejtorisë së Çështjeve Sociale* për raportimin e dhunës në situatë emergjence.

Në **Bashkinë Selenicë** janë zhvilluar takime online të vazhdueshme për të bashkërenduar punën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje midis punonjësve të Policisë së Shtetit, të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë, mësuesve dhe edukatorëve dhe punonjësve të shëndetësisë.


Bashkia Devoll ka nënshkruar një marrëveshje me “Linjën e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat”. Linja e Këshillimit do të ofrojë nëpërmjet linjës telefonike informacione dhe do

të adresojë sipas nevojave mbështetjen përkatëse. Numri telefonik do të vendoset në faqen zyrtare të Bashkisë Devoll.

IV. MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për rastet e dhunës në familje përbëhet nga:

- Komiteti Drejtues (KD) “Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje”, të cilat funksionojnë pranë çdo bashkie.
- Ekipi Teknik Ndërdisciplinor (ETN), i cili përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues, të përbërë nga përfaqësues teknik/specialistë të institucioneve të përfaqësuara në MKR.
- Koordinatori(ja) Vendor(e) kundër Dhunës në Familje (KVDHF) – Specialist(e) i(e) emëruar me kohë të plotë në Bashki, me detyrimin dhe përgjegjësinë për të përmbushur detyrat e përcaktuara në VKM nr. 334, datë 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Institucionet pjesë e MKR-së janë:



Po ashtu, bashkitë kanë kryer shërbimet për rastet e dhunës në familje, duke respektuar edhe protokollet për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit gjatë situatës së Covid-19, miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, drejtuar në mënyrë të veçantë anëtarëve të ETN-së. Për

shkak të rregullave të vendosura të distancimit social, takimet e ETN-së në të shumtën e bashkivë janë realizuar kryesisht online për të diskutuar rreth rasteve të dhunës në familje të identifikuara gjatë kësaj periudhe.

Më poshtë është prezantuar situata e menaxhimit të rasteve të dhunës të identifikuara përgjatë periudhës së izolimit për shkak të pandemisë Covid-19 sipas bashkive respektive:

BASHKIA SHKODËR

Në vitin
2020

- 40 raste të menaxhuara

Në Bashkinë Shkodër në respektim të masave të ndërmarra si përgjigje ndaj Covid-19 përgjatë kësaj kohë ETN-ja nuk është mbledhur fizikisht. Të gjitha rastet e dhunës në familje janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare "Për Familjen", pjesë e kësaj drejtorie në bashkëpunim të ngushtë me disa nga aktorët kryesore të MKR-së, si: Policia Vendore e Policisë Shkodër, organizatat e shoqërisë civile (gruaja tek gruaja, Gruaja në Integrim, Shpresë për Botën, etj.), Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër dhe NJVKSH Shkodër, në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës. Në vitin 2020 përgjatë situatës së Covid-19, në Bashkinë Shkodër janë menaxhuar 40 raste, nga të cilat 13 me UMM dhe 10 me UM. Ndërsa në vitin 2019 për të njejtën periudhë janë menaxhuar 12 raste, nga të cilat 2 UMM dhe 10 UM.

Në vitin
2019

- 12 raste të menaxhuara

Gjatë kësaj periudhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP-së, në kuadër të programit të përbashkët "T'i japim fund dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri" ka përgatitur dy protokolle për t'iu ardhur në ndihmë të gjithë MKR-ve duke synuar në një praktikë të unifikuar për të gjitha bashkitë. Në këtë kuadër iu janë dërguar me email dhe shkresë zyrtare të gjithë institucioneve pjesë e MKR-së protokollat përkatëse dhe janë organizuar dy trajnime me anëtarët e MKR-së për zbatimin e këtij protokolli.

Bashkia Shkodër përgjatë periudhës mars-qershor 2020 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar në total 40 raste të dhunës në familje. Përpos rasteve të reja vazhdon menaxhimi dhe monitorimi i urdhërave të mbrojtjes që janë në fuqi nga muajt e mëparshëm (viti 2019).

Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19, kujdesi i stafit ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Në vijim të kontaktit dhe rekomandimeve të vazhdueshme

të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, konkretisht me sektorin e Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, komunikimi me rastet është realizuar përmes telefonit dhe në rastet e nevojshme janë realizuar edhe vizitat në familje në bashkëpunim me SPZ-të e zonës, me të cilët bashkëpunimi ka qënë ka qenë efektiv.

BASHKIA BELSH

Në vitin
2020

- 2 raste të menaxhuara

Në vitin
2019

- 3 raste të menaxhuara

Në **Bashkinë Belsh**, MKR-ja nuk është mbledhur gjatë periudhës së izolimit për shkak të Covid-19. Gjatë kësaj periudhe në Bashkinë Belsh ka patur një rënie të vogël të rasteve të raportuara të DHF dhe DHBGJ në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë. Në 2019 ka patur 3 raste, ndërsa në 2020 janë identifikuar 2 raste. Sipas pjesëmarrësve në fokus grup, situata nuk paraqitet problematike dhe puna ka vijuar normalisht, por me ngarkesa të larta që lidhen me koordinimin e ndihmës ekonomike në ushqime dhe veshmbathje për shtresat në nevojë duke përfshirë edhe rastet e dhunuara. Rasti i vetëm me urdhër mbrojtjeje është ndjekur normalisht nga Bashkia dhe Koordinatorja Vendore ofron gjithmonë një relacion dhe informacion të detajuar të rasteve.

Në bashkinë Belsh, gjatë periudhës së COVID-19, nisur edhe nga situata e rasteve të raportuar, nuk është bërë monitorimi i Urdhrave të Mbrojtjes, por janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me rastet dhe me policinë.

BASHKIA DELVINË

Në vitin
2020

- 0 raste të menaxhuara

Në vitin
2019

- 0 raste të menaxhuara

Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, **Bashkia Delvinë** nuk ka patur raste raportimi të dhunës. Po ashtu, edhe për vitin 2019 raportohen 0 raste të identifikuara. Pavarësisht kësaj, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) ka funksionuar në Bashkinë Delvinë dhe është mbledhur online gjatë kësaj periudhe. Koordinatorët Vendorë kanë raportuar periodikisht pranë Komisionit të Barazisë Gjinore si dhe janë hartuar protokolle për funksionimin e MKR-së si gjatë pandemisë, edhe post pandemie.

Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 është respektuar protokolli i masave parandaluese. Për secilin nga rastet, komunikimi midis Komisionit të Barazisë Gjinore dhe administratës në Bashki është realizuar duke përdorur mjetet e komunikimit online.

Edhe pse gjatë periudhës së pandemisë Bashkia Delvinë nuk ka patur raste raportimi të dhunës në familje, por në bashkëpunim me OJF “Jona” dhe Policisë në Delvinë po trajtohet 1 rast i dhunës seksuale që është raportuar në fundvitin e 2019-tës.

BASHKIA LUSHNJE

Në vitin
2020

- 9 raste të menaxhuara

Në vitin
2019

- 19 raste të menaxhuara

Rastet e dhunës janë referuar nga institucionet pjesë e Mekanizimit të Koordinuar të Referimit në **Bashkinë Lushnje**, në mënyrë periodike duke kërkuar gjithmonë shërbim të specializuar. Për periudhën mars-maj 2020 janë identifikuar 9 raste kundrejt 19 rasteve të identifikuara në vitin 2019. MKR-ja ka bashkërenduar punën me të gjithë anëtarët pjesë e këtij mekanizmi duke i ndjekur rastet e dhunës për rastet të dhunës së ushtruar nga grave, ndaj fëmijëve apo personave të tjerë në familje.

BASHKIA ELBASAN

Në vitin
2020

- 36 raste të menaxhuara

Në vitin
2019

- 15 raste të menaxhuara

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 bashkërendimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë **Bashkisë Elbasan** ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Takimi i fundit i realizuar nga MKR Elbasan është zhvilluar më datë 09 mars 2020. Komunikimi në vijim midis anëtarëve është realizuar përmes telefonit dhe në rastet e nevojshme janë realizuar edhe vizita në familje në bashkëpunim me SPZ-të e zonës.

Për periudhën mars-prill 2020, janë identifikuar 10 raste të dhunës, përkatësisht: 3 UMM dhe 2 UM janë lëshuar në muajin mars 2020 dhe 2 UMM dhe 3 UM janë lëshuar në muajin prill 2020. Ndërsa, në vitin 2019 janë trajtuar 15 raste, nga të cilat: 6 me UMM dhe 1 UM në muajin mars 2019 dhe 3 UMM dhe 5 UM në muajin prill 2019.

Krahas rasteve të reja, përgjatë periudhës janar-prill janë trajtuar dhe monitoruar edhe urdhrat e tjerë të mbrojtjes, që janë në fuqi nga muajt e mëparshëm. Në total, janë menaxhuar dhe trajtuar 36 raste.

Gjatë periudhës mars – prill 2020, ETN-ja nuk është mbledhur. Të gjitha rastet janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Komunitare në Bashkinë e Elbasanit, si dhe nga specialistët e Policimit në Komunitet dhe anëtarët e tjerë të MKR-së, si Policia Vendore Elbasan, Njësia e Mbrojtjes për të drejtat e fëmijëve, organizatat e shoqërisë civile, si A2B, Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Tjetër Vizion, Forumi i Gruas Elbasan.

Koordinatorja Vendore në Bashkinë Elbasan i ka kryer funksionet e saj sipas grafikut të planifikuar. Komunikimin, monitorimin dhe menaxhimin e rasteve e ka realizuar nëpërmjet bisedave telefonike dhe takimeve të drejtpërdrejta duke ruajtur distancat e sigurisë. Ky proces është mbështetur edhe nga specialistët e Policimit në Komunitet dhe anëtarët e tjerë të MKR-së, për identifikimin dhe mbështetjen e rasteve të dhunës në familje. Policia është vënë në dijeni për çdo rast shkelje të UMM/UM të evidentuar nga Koordinatorja Vendore. Puna është koordinuar me SPZ përkatëse për rastet me nivel risku të mesëm e të lartë.

BASHKIA PEQIN

Në vitin
2020

- 5 raste të menaxhuara

Në **Bashkinë Peqin**, sipas protokolleve, MKR-ja është mbledhur 2 herë për diskutimin e situatës të dhunës në familje. Bazuar në të dhënat nga koordinatori e dhunës në Bashkinë e Peqinit, gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19, janë adresuar 5 raste gjithsej, nga të cilat 4 raste me urdhër mbrojtje dhe 1 rast pa urdhër mbrojtje.

Në vitin
2019

- 1 rast i menaxhuar

Në të njëjtën periudhë me 2019 ka qenë vetëm 1 rast pa urdhër mbrojtje. Koordinatorët vendorë kanë raportuar në mënyrë periodike pranë KBGJ-së për rastet e dhunës në familje. Në Bashkinë Peqin rastet me Urdhër Mbrojtje kanë qenë nën monitorimin e policisë dhe përfaqësuesve të Shërbimit Social bashkiak.

BASHKIA GJIROKASTËR

Në **Bashkinë Gjirokastrë**, gjatë periudhës së Covid-19 nuk ka patur mbledhje fizike të MKR-së pasi nuk ka pasur një rast konkret, i cili të shfaqte këtë nevojë. Për periudhën Mars-Maj 2020, janë identifikuar 3 raste të dhunës në familje dhe 10 raste janë identifikuar në 2019 për të njëjtën periudhë.

Në vitin
2020

- 3 raste të menaxhuara

Janë organizuar tri (3) mbledhje online nëpërmjet platformave të cilat mundësojnë realizimin e mbledhjeve. MKR-ja ka diskutuar për problemet që mund të hasen si dhe zgjidhjet, pra për një parapërgatitje për situata të caktuara, të cilat mund të kenë një natyrë më komplekse dhe kërkojnë trajtime specifike.

Në vitin
2019

- 10 raste të menaxhuara

Në Bashkinë Gjirokastrë situata, në përgjithësi, është menaxhuar mirë pasi nuk ka patur raste urgjente. Rastet ekzistuese janë monitoruar normalisht dhe vëmendje i është dhënë shpërndarjes së ndihmave ushqimore, si dhe monitorimit të situatës përmes telefonit.

Në Bashkinë Gjirokastrë, sipas parashikimeve ligjore (Ligji Nr.9696/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar), raporti periodik i monitorimit të zbatimit të Urdhërit të Mbrojtjes për rastet e dhunës në familje, çdo 60 ditë i vihet në dispozicion nga koordinatori vendore strukturave të policisë së shtetit në NJVV ku kryhet monitorimi. Për të zbatuar protokollin për mbrojtje gjatë pandemisë, ky raport është kryer përmes telefonit me viktimën dhe/ose të afërm. Komunikimi ka qenë i vazhdueshëm për të parë ecurinë e UM-ve. Më pas një kopje e këtij raporti i është dërguar policisë së shtetit për informim lidhur me situatën.

BASHKIA DROPULL

Në vitin
2020

- 1 rast menaxhuar

Numri i rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në muajt e fundit të raportuar në **Bashkinë Dropull** ka qenë vetëm një.

Për të vetmin rast të paraqitur gjatë kësaj periudhe, po kryhet monitorimi i zbatimit nga palët të Urdhërit të Mbrojtjes, por nëpërmjet komunikimit telefonik, për shkak të kufizimeve për shkak të Covid-19, gjithashtu edhe sepse e mbijetuara ndodhet jashtë Shqipërisë. Raporti i monitorimit i është vënë në dispozicion policisë.

Bashkia Dropull ka ngritur Mekanizmin e Koordinimit të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në dhjetor 2019. Formalizimi i MKR-së është bërë përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për këtë qëllim, në datën 05.12.2019 nga 15 anëtarët: Bashkia Dropull, Komisariati i Policisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Zyra Vendore e Përmbarimit, Mjeku Ligjor, Gjirokastrë, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Spitali Rajonal Gjirokastrë, Qendra Shëndetësore Dropull i Sipërm, Qendra Shëndetësore Dropull i Poshtëm, Zyra Vendore Arsimore, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Gjithashtu, duke filluar nga data 08/11/2019, pranë Bashkisë Dropull në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar është emëruar dhe një punonjëse me kohë të plotë në pozicionin e Koordinatorës Vendore Kundër Dhunës në Familje MKR Dropull. Po ashtu, janë në funksion edhe: Komiteti Drejtues (titullarët e të gjitha institucioneve anëtare të sipërpërmendura), Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (specialistët që trajtojnë rastet, nga një përfaqësues për secilin institucion anëtar) si dhe Koordinatorja Vendore.

Që me fillimet e funksionimit të MKR-së, Koordinatorja Vendore kundër dhunës në familje ka marrë një sërë trajnimesh. Komiteti Drejtues e ka zhvilluar mbledhjen e parë të tij në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për formalizimin e MKR-së, ndërkohë që është mbledhur sërish gjatë muajit qershor për të miratuar protokollet e sipërpërmendura.

ETN-ja është mbledhur dy herë gjatë këtij viti, në dy trajnime të zhvilluara më 22 janar 2020, mbi kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrimet e ETN-së, si dhe në shkurt 2020 mbi dhunën seksuale dhe trajtimin e rasteve të tilla nga MKR-të. Gjatë pandemisë nuk ka pasur takime për shkak se edhe i vetmi rast është trajtuar me dy-tre anëtarët përgjegjës, por janë mbajtur kontakte me anëtarët e MKR-së rregullisht dhe iu është dërguar një informacion i shkurtër nëpërmjet e-mailit për t'i mbajtur të informuar anëtarët e ETN-së që nuk ka pasur raste të reja për trajtim. Pavarësisht situatës së pandemisë, komunikimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse ka qënë i koordinuar dhe është bërë në mënyrë të vazhdueshme.

Në bashkinë Dropull është bërë ndjekja e vazhdueshme dhe monitorimi i situatës në lidhje me zbatimin të UMM-ve nga aktorët vendorë dhe nga struktura përgjegjëse në Bashki.

BASHKIA VLORE

Në vitin
2020
janar-
qershor

- 50 raste të menaxhuara

Grupi teknik multidisiplinar në **Bashkinë Vlorë** është mbledhur 2 herë me pjesëmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të institucioneve publike dhe organizatave jo-fitimprurese që janë pjesë e këtij grupi. Sipas Qendrës Vatra, gjatë izolimit nga pandemia Covid-19, janë shënuar 22 raste dhune më shumë krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në vitin
2019
janar-
qershor

- 50 raste të menaxhuara

Ndërsa, rastet e dhunës së denoncuar në policinë e shtetit janë në të njëjtat shifra me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Edhe numri i rasteve të urdhrave të mbrojtjes të referuara nga Prokuroria dhe Gjykata në bashki nuk ka qënë i shtuar.

Urdhrat e Mbrojtjes në **Bashkinë Vlorë** janë monitoruar nëpërmjet kontaktit telefonik dhe rrjeteve sociale nga ana e Koordinatorës Vendore të dhunës në familje sipas vendimeve të Gjykatës.

BASHKIA POLIÇAN

Në vitin
2020
dhe
2019

- 0 raste të menaxhuara

Në **Bashkinë Poliçan** MKR-ja nuk është mbledhur, por nuk është hartuar asnjë plan monitorimi. Pavarësisht se nuk ka pasur raste të dhunës të identifikuara, gjatë zhvillimit të fokus grupit është theksuar se arsyet që viktimat e dhunës nuk raportojnë lidhet me gjendjen e tyre të ulët ekonomike, që ndikon në varësinë e tyre ekonomike nga dhunuesit. Gratë nuk gjejnë mbështetje dhe kanë pasiguri në zgjidhjen e problemit të tyre nga ana e sistemit, pasi as Bashkia nuk ka buxhet në dispozicion. Sipas mjekeve pjesëmarrëse në fokus grup, gratë e gjejnë zgjidhjen e nevojave të tyre psikologjike përmes qetësuesve.

BASHKIA GRAMSH

Në vitin
2020

- 5 raste të menaxhuara

Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, në **Bashkinë Gramsh** nuk ka patur takime fizike me anëtarët e Ekipit Teknik Ndërsektorial (ETN), në zbatim të udhëzimit të nxjerrë nga Ministria për mos mbledhjen e grupeve me shumë persona. Për periudhën janar- maj 2020 janë raportuar 5 raste dhe janë lëshuar 4 UM. Ndërsa, për periudhën janar –maj 2019 janë raportuar 7 raste dhe janë lëshuar 10 UM përgjatë gjithë vitit 2019.

Në vitin
2019

- 7 raste të menaxhuara

Bashkëpunimi është realizuar nëpërmjet telefonit për të ofruar shërbim dhe për të mësuar mbi raste të reja të mundshme, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe për të reaguar për çdo dyshim të mundshëm për rastet e dhunës në familje.

Bashkia Gramsh dhe komisarati i policisë ka pasur një bashkëpunim të rregullt për monitorimin e rasteve të dhunës në familje dhe ndjekjen e çdo rasti të ri.

BASHKIA SKRAPAR

Në vitin
2020

- 0 raste të menaxhuara

Gjatë pandemisë së Covid-19, **Bashkia Skrapar** nuk ka pasur raste të denoncuar të dhunës në familje.

Në Bashkinë Skrapar është respektuar protokoli për masat parandaluese dhe komunikimi i informacioneve është kryer përmes postave elektronike. Koordinatorët vendorë kanë raportuar në mënyrë periodike pranë Komisionin të Barazisë Gjimore, pavarësisht që nuk ka raste të adresuara.

BASHKIA LIBOHOVË

Në vitin
2020

• 0 raste të
menaxhuara

Bashkia Libohovë është mbledhur online për të qenë në gatishmëri, por gjatë kësaj periudhe nuk ka patur denoncime të rasteve të dhunës.

Në vitin
2020

• 1 rast i
menaxhuar

BASHKIA MIRDITË

Në vitin
2020

• 0 raste të
menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për rastet e dhunës në familje nuk është i ngritur në **Bashkinë Mirditë**. Gjatë periudhës së pandemisë nuk janë realizuar mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor, për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19.

Në bashkinë Mirditë të gjitha rastet që trajtohen me Urdhër Mbrojtje monitorohen nga shërbimet sociale në Bashki. Çdo muaj mbahet kontakt me personat e dhunuar dhe nëse ka raste që të dhunuarit lëvizin nëpër rrethe të tjera bëhen dhe vizita në familje. Policia është kontaktuar në rastet kur ka patur ankesa për shkelje nga dhunuesit.

BASHKIA KAMËZ

Në vitin
2020

• 96 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Kamëz** sistemi i referimit është ringritur dhe riaktivizuar në Qershor të 2018-ës dhe janë realizuar takime të përmuajshme. Takimet e zhvilluara janë zhvilluar të gjitha online përmes platformave "Skype" dhe "Zoom". Situata është monitoruar nëpërmjet telefonatave dhe në rastet prioritare me rrezikshmëri të lartë është realizuar kontaktimi direkt i personave të dhunuar, duke ndjekur masat sipas protokollit të sigurisë. Policia ka asistuar të gjitha rastet e dhunës në familje edhe gjatë Covid-19. Transporti është siguruar nga Komisariati dhe në raste të tjera nga organizata jofitimprurëse.

Në vitin
2019

• 50 raste të
menaxhuara

Numri i rasteve të dhunës në familje për periudhën e raportuar për vitin 2020 ka arritur në 96 raste të raportuara në Komisariat. Ndërsa, në vitin 2019 për të njejtën periudhë ka pasur 50 rasteve në menaxhim.

Rastet e denoncuar në komisariat për dhunën ndaj të miturve, konsiderohen raste prioritare me risqe të larta. Fëmijët marrin mbrojtje të menjëhershme

dhe vendosën në qendrën e emergjencës dhe më pas drejtohen tek organizatat partnere, të cilat ofrojnë shërbimet e nevojshme.

Për menaxhimin e rasteve të dhunës, bashkia Kamëz ka trajtuar si më poshtë:

- 1 rast është dërguar në Qendrën e Trajtimin të Viktimave të Dhunës në Familje.
- 1 Rast është referuar tek Linja e Këshillimit të Vajzave dhe Grave ALO 116 117.
- 7 raste janë referuar për shërbim ligjor falas tek TLAS.
- 4 raste janë referuar tek Zyra e Punës për mundësi punësimi.
- 2 raste janë referuar tek Drejtoria e Çështjeve të Strehimit për përfitim të bonusit të qerasë dhe 1 rast tek organizatat.

Takim i Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN) nuk është zhvilluar për shkak të situatës së Covid-19, por të gjitha shërbimet janë ofruar nga komunikimet individuale me secilin aktor. Koordinator Vendor dhe Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve kanë siguruar mbarëvajtjen e sistemit të referimit dhe ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijëve pavarësisht pandemisë. Kjo është siguruar nëpërmjet ruajtjes së kontakteve intensive me aktorët e tjerë të mekanizmit dhe referimit të rasteve tek OJF-të për ofrimin e shërbimeve në kushtet e emergjencës.

Në Bashkinë Kamëz, monitorimi i rasteve të DHF gjatë Covid-19 është realizuar nga Koordinatorja Vendore nëpërmjet vizitave në familje dhe nëpërmjet kontakteve nga telefoni. Po ashtu, edhe në bashkëpunimin me Komisaratin Nr. 5 Kamëz dhe SPZ-të e zonës.

BASHKIA MALIQ

Në vitin
2020

• 5 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Maliq**, MKR-ja për rastet e dhunës në familje ka organizuar mbledhje online të vazhdueshme në bazë të rasteve të paraqitura si dhe mbi rëndësinë e njohjes së protokollit nga Komiteti Drejtues, në mbrojtje të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare për unifikimin e veprimeve të institucioneve vendore, në procesin e menaxhimit të rasteve. Anëtarët e ETN-së janë informuar mbi rëndësinë e funksionimit të ETN-së edhe në situatën e pandemisë dhe mënyrat sesi mund të ofrohen shërbime duke adresuar nevojat e rasteve, por edhe për sigurinë e profesionistëve.

Në vitin
2019

• 4 raste të
menaxhuara

Koordinatorët vendorë kanë raportuar në mënyrë periodike pranë KBGJ-së për problematikat e dhunës në familje, sidomos në zonat rurale, ku informacioni është më i kufizuar.

Bashkia Maliq për monitorimin e Urdhrave të Mbrojtjes ka bashkëpunuar me bashkitë e tjera ku viktimat/ të mbijetuarit e dhunës në familje janë rezidentë dhe ka referuar rastet përkatëse.

BASHKIA KLOS

Në vitin
2020

- 4 raste të menaxhuara

Në **bashkinë Klos** MKR-ja është mbledhur me datë 10 Dhjetor 2019 ku është riformalizuar me mbështetjen e UNDP.

Në vitin
2019

- 2 raste të menaxhuara

Ekipi Teknik Ndërdisciplinor është mbledhur me datë 16 Janar 2020 dhe 14 shkurt 2020. Edhe pse ETN-ja është mbledhur dy herë gjatë vitit 2020, vështirësia qëndron tek mungesa e pjesëmarrjes të të gjithë anëtarëve: gjykata dhe zyra e përmbaramit. Gjatë pandemisë Covid-19 nuk janë zhvilluar mbledhje të ETN-së. Gjatë vitit 2020, janë lëshuar vetëm 2 UM, si dhe janë menaxhuar 2 raste të dhunës në familje të vitit 2020, por edhe 2 raste të vitit 2019.

Në bashkinë Klos Urdhrat e Mbrojtjes janë lëshur gjatë muajit Qershor 2020 ndaj nuk ka pasur monitorim të tyre gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 gjatë izolimit.

BASHKIA KORÇË

Në vitin
2020

- 20 raste të menaxhuara

Gjatë periudhës së Covid-19 në **Bashkinë Korçë** u vu re një rënie e rasteve të raportuara të dhunës në familje. Gjatë periudhës mars-maj 2019 ka patur 32 raste të raportuara, nga të cilat 27 gra dhe 5 burra, ndërsa në periudhën Mars-Maj 2020 ka patur 20 raste të raportuara nga të cilat 17 gra dhe 3 burra. Pavarësisht rënies në shifra, ekspertët e fushës, punonjësit e Bashkisë, por edhe aktorët kyç që punojnë në këtë sektor, pohojnë se kjo rënie nuk shpjegohet me uljen e rasteve të dhunës, por me pamundësinë e raportimit duke patur parasysh që individët qëndronin të izoluar sëbashku gjatë 24 orëve. Kjo vërtetohet, gjithashtu, edhe me faktin që pas ndërprerjes së izolimit ka patur rritje të raportimeve. Një monitorim i mëtejshëm i situatës duke përfshirë edhe numrin e divorceve post Covid-19 mund të identifikojë më tej situatën reale.

Në vitin
2019

- 32 raste të menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) është mbledhur dy herë gjatë periudhës së pandemisë. Takimi i fundit i realizuar nga MKR Korçë është zhvilluar në datën 11/5/2020. Komunikimi është bërë online për të diskutuar rreth rasteve të ndodhura gjatë kësaj periudhe. Në mbledhjen e datës 2/4/2020 është diskutuar rreth rasteve të trajtuara gjatë 3 muajit Janar-Mars 2020.

Rastet e evidentuara në rajonin e Policisë marrin mbështetje nga Koordinatorja Vendore për Barazinë Gjinore, e cila është përgjegjëse për identifikimin e nevojave dhe ofrimin e

shërbimeve specifike. Nga të gjitha rastet e raportuara gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me policinë vetëm në një rast dhunuesi është mbajtur larg shtëpisë.

Për monitorimin e situatës në bashkinë Korçë policia kishte marrë udhëzime të veçanta për të kontrolluar apo vëzhguar rastet apo familjet, për të cilat kishte informacion paraprak që kanë problematika për ushtrim të dhunës.

BASHKIA SHIJAK

Në vitin
2020

• 14 raste të
menaxhuara

Në vitin
2019

• 13 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Shijak**, është realizuar një marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve përgjegjëse dhe po punohet për ngritjen e MKR-së dhe së shpejti do të kryhet mbledhja e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN), me anëtarët nga çdo institucion përgjegjës për t'iu ardhur në ndihmë rasteve të dhunës në familje. Institucionet të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për ngritjen e MKR-së janë: Bashkia Shijak, Komisariati i Policisë Shijak, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Prokuroria e Rrethit Durrës, Qendra Shëndetësore Shijak, Zyra e Shërbimit Social Bashkia Shijak, Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, Zyra Rajonale e Punësimit Durrës.

Në bashkinë Shijak bazuar në legjislacion dhe sipas Protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Koordinator i Vendor për Dhunën në Familje çdo 60 ditë duhet të përgatisë një raport për monitorimin e urdhrave të mbrojtjes dhe ky raport të vihet në dispozicion të policisë, në rast se ka shkelje të UM-ve.

BASHKIA KURBIN

Në vitin
2020

• 15 raste të
menaxhuara

Në vitin
2019

• 9 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Kurbin** Komiteti Drejtues dhe Mekanizmi i Koordinuar i Referimit nuk është i ngritur. Bashkia Kurbin është në proces hartimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis institucioneve dhe për rastet e dhunës ndiqen hapat në bazë të Ligjit Nr.9669, datë 18.12. 2006, i ndryshuar.

Për periudhën mars-qershor 2020 janë raportuar 15 raste, nga të cilat 10 raste janë pajisur me UM dhe 5 raste janë pajisur me UMM. Ndërsa në vitin 2019 për të njejtën periudhë janë raportuar 9 raste, nga të cilat 5 raste janë pajisur me UM dhe 4 raste janë pajisur me UMM.

Në bashkinë Kurbin për monitorimin e rasteve të dhunës në familje janë mbajtur kontakte telefonike dhe përgatitur raporte psiko-sociale, të cilat i janë paraqitur gjykatës.

BASHKIA MALËSI E MADHE

Në vitin
2020

• 6 raste të
menaxhuara

Në vitin
2019

• 2 raste të
menaxhuara

Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, në **Bashkinë Malësi e Madhe** MKR-ja ka funksionuar duke ofruar mbështetje me ndihma ushqimore dhe këshillim sipas nevojave të paraqitura. Po ashtu, janë organizuar mbledhje të ETN-së online. Temat e diskutuara kanë qenë mbi: situatën e dhunës në familje, vështirësitë e hasura, dhe për 2 Protokollat: 1) Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes mekanizmit të referimit gjatë situatës COVID-19 dhe 2) Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes MKR-së.

Gjatë kësaj periudhe, në Bashkinë Malësi e Madhe është kryer monitorimi i urdhrave të mbrojtjes, por për shkak se njësitë administrative kanë distancë nga njëra-tjetra, për situatën e COVID-19 janë angazhuar punonjëset sociale të njësive për të marrë informacion mbi situatën në të cilën ndodhen personat e dhunuar. Të gjitha rastet janë larguar nga vendi ku kanë jetuar me dhunuesit dhe janë dërguar në një mjedis më të sigurtë.

BASHKIA PUSTEC

Në vitin
2020

• 1 rast i
menaxhuar

Në **Bashkinë Pustec** Mekanizmi i Koordinuar i Referimit nuk ka funksionuar dhe midis anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN) nuk ka pasur komunikim dhe nuk është zhvilluar asnjë takim. Koordinatorja vendore e dhunës nuk ka kontakt zyrtar me policinë, edhe pse këto janë dy aktorë kryesorë në mbështetjen për adresimin e dhunës në familje.

Në vitin
2019

• 0 raste të
menaxhuara

Në bashkinë Pustec monitorimi i rasteve të dhunës është realizuar përmes kontakteve telefonike.

BASHKIA ROSKTOVEC

Në vitin
2020

• 15 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Roskovec** gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, për periudhën Mars-Maj, janë zhvilluar 2 takime online të rregullta të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar dhe trajnim online për Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të dhunës në Familje. Ndërkohë, koordinatoreja vendore ka ndjekur edhe trajnime të tjera mbi Protokollin e Menaxhimit të strehëzave gjatë periudhës së pandemisë, trajnim mbi menaxhimin e rasteve të dhunës dhe trajnimin mbi sistemin REVALB.

Në vitin
2019

• 3 raste të
menaxhuara

Gjatë vitit 2020 u evidentuan 10 raste dhune, nga të cilat 5 ishin gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Shkak ka qenë izolimi i detyruar për rastet e dhunës në familje. Dy prej rasteve iu është dhënë shërbim ligjor falas, në kuadër të projektit: “Forcimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës” nga UNDP. Nga viti në vit dallohet qartë një rritje e padive ndaj dhunës, pasi Bashkia ka përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe ka forcuar mbrojtjen ndaj viktimave.

Raporti i fundit i Bashkisë Roskovec i është dërguar policisë mbi rezultatet e monitorimit në Shkurt 2020. Gjithashtu, po përgatitet raporti tjetër për 10 rastet e reja nga janari 2020 dhe për 4 rastet me Urdhër Mbrojtje aktive.

BASHKIA KUKËS

Në vitin
2020

• 9 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Kukës** gjatë periudhës së pandemisë, duke respektuar dhe rregullat e distancimit social është përdorur informimi i ETN-së, duke përdorur adresat e emailit të anëtarëve. Anëtarët janë informuar për secilin rast dhe nga ana e tyre, rasti është trajtuar duke dhënë sugjerimet për hartimin e planit të ndërhyrjes. Bashkia ka vendosur strukturat dhe burimet ekzistuese përkatëse për kontaktim. Koordinatorët vendorë kanë raportuar një herë në javë pranë Komisionit të Barazisë Gjinore dhe të Mbrojtjes Sociale, për numrin e viktimave të dhunës të kontaktuara, si masë parandaluese për dhunën.

Në vitin
2019

• 7 raste të
menaxhuara

Bazuar në të dhënat e marra nga Koordinatorja Vendore e Dhunës në Familje në Bashki, për periudhën Janar – Mars 2020 janë raportuar 9 raste të dhunës në familje, nga të cilat 6 raste janë raportuar gjatë periudhës së izolimit të pandemisë të shkaktuar nga Covid-19.

Monitorimi i tyre është kryer në bashkëpunim me punonjësit e policisë. Raportet e monitorimit janë përgatitur për secilin rast dhe nuk janë konstatuar shkelje të urdhrave të mbrojtjes.

BASHKIA DIVJAKË

Në vitin
2020

• 14 raste të
menaxhuara

Rastet e dhunës në **Bashkinë Divjakë** janë referuar nga institucionet pjesë e mekanizmit të referimit në mënyrë periodike. Gjithashtu, për rastet më emergjente është mbledhur ETN-ja fizikisht duke respektuar të gjitha rregullat e distancimit social.

Në vitin
2019

• 15 raste të
menaxhuara

Për periudhën Mars-Maj 2020 janë dhënë 14 UMM nga gjykata e rrethit gjyqësor Lushnje, dhe të gjitha rastet janë verifikuar nga Koordinatorja e Dhunës në Familje, në bashkëpunim me administratorin shoqëror të njësive përkatëse. Rasteve iu është dhënë ndihma e nevojshme, duke iu ofruar të gjitha shërbimet përkatëse. Nuk ka qenë i mundur raportimi i raportit tre mujor në Komisaratin e Policisë për shkak të pandemisë Covid-19.

Gjithashtu, janë ndeshur vështirësi për menaxhimin e rasteve për shkak të pamundësisë për të bërë vizita në familje.

BASHKIA KOLONJË

Në vitin
2020

• 2 raste të
menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit në **Bashkinë Kolonjë** nuk është mbledhur, pasi rastet e dhunës në familje nuk kanë paraqitur vështirësi në menaxhimin e tyre dhe nuk janë paraqitur raste emergjente.

Në vitin
2019

• 1 rast i
menaxhuar

Monitorimi i UM-së për rastet në menaxhim është duke u realizuar sipas procedurës dhe nuk janë paraqitur problematika në zbatim.

BASHKIA MALLAKASTËR

Në vitin
2020

• 4 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Mallakastër** MKR-ja përgjatë periudhës Covid-19 ka qenë në bashkërendim të punës për menaxhimin e rasteve të dhunës dhe është mbledhur 4 herë online.

Në vitin
2019

• 3 raste të
menaxhuara

Informacioni është marrë pasi viktimat e dhunës kanë informuar organet e policisë dhe në vijim pas kontaktimit nga policia të Administratës së Shërbimeve Sociale në Bashki, menjëherë ka nisur procesi mbështetës me shërbime afat-shkurtra.

Shërbime afat-shkurtra përfshijnë: mbrojtje të menjëhershme dhe siguri nga policia, shoqërim për mbështetje shëndetësore nga stafi mjekësor zonal dhe punonjësit social të Bashkisë, ofrim shërbimi psikologjik nga psikologu i ZVA, dhe, gjithashtu, ndjekje dhe informacion për fillimin e procedurave për urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes. Këto raste janë referuar edhe pranë KBGJ-së në Këshillin Bashkiak. Për të 4 rastet e dhunës vazhdon monitorimi sipas procedurës ligjore.

BASHKIA KËLCYRË

Në vitin
2020

• 5 raste të
menaxhuara

MKR në **Bashkinë Këlcyrë** gjatë COVID-19 ka realizuar komunikimet në mënyrë elektronike. Për rastet e dhunës, informacioni është përcjellë nga Policia e Këlcyrës dhe janë marrë menjëherë në mbrojtje nga policia.

Në bashkëpunim me specialisten e çështjeve sociale në Bashki personave të dhunuar iu janë ofruar paketa ushqimore. Nën sigurinë e policisë dhe të stafit të çështjeve sociale të Bashkisë, personat e dhunuar janë shoqëruar për mjekim në spitalin e Këlcyrës.

Në vitin
2019

• 6 raste të
menaxhuara

Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, përkatësisht nga shërbimi social në Bashki dhe nga Koordinatorja e dhunës, janë monitoruar rastet sipas procedurës ligjore.

Gjatë pandemisë Covid-19 janë marrë në mbrojtje nga policia 2 viktima të dhunës, ku 1 prej rasteve është abuzim seksual dhe 1 rast është dhunë e bashkëshortit ndaj bashkëshortes. Ndërsa, rastet e tjera janë raportim për dhunë psikologjike nga rrethi i të afërmeve.

BASHKIA MEMALIAJ

Në vitin
2020

• 0 raste të
menaxhuara

Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 MKR ka funksionuar dhe është mbledhur 1 herë online. Përgjatë kësaj periudhe në **Bashkinë Memaliaj** nuk ka patur raste të referuara të dhunës. Koordinatorja vendore ka raportuar periodikisht pranë KBGj-së. Po ashtu, janë hartuar protokolle për funksionimin e MKR si gjatë pandemisë, edhe post pandemie.

Në vitin
2019

• 1 rast i
menaxhuar

BASHKIA PATOS

Në vitin
2019

• 5 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Patos**, është ngritur dhe funksionon Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për rastet e dhunës në familje që prej vitit 2014. Gjatë periudhës Mars-Korrik 2020 në Bashkinë Patos, ETN-ja është mbledhur rregullisht dhe ka zhvilluar mbledhjet e përmuajshme, me qëllim ndarjen e informacioneve mbi rastet e reja dhe ecurinë e

Në vitin
2020

• 9 raste të
menaxhuara

trajtimit të rasteve ekzistuese. Mbledhja e muajit mars është zhvilluar në fillim muaji dhe anëtarët e ETN-së janë mbledhur fizikisht, ndërsa në muajt vijues takimet janë zhvilluar online.

Gjatë periudhës së pandemisë monitorimi i urdhërave të mbrojtjes është realizuar nëpërmjet komunikimeve telefonike me viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje.

BASHKIA HAS

Në vitin
2020

• 2 raste të
menaxhuara

Përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19 në **Bashkinë Has** MKR-ja është mbledhur dy herë dhe koordinatorët vendorë kanë raportuar periodikisht pranë Komisionit të Barazisë Gjinore. Për funksionimin e MKR-së janë hartuar protokolle si gjatë pandemisë, edhe post pandemisë.

Në vitin
2019

• 0 raste të
menaxhuara

Pavarësisht situatës së vështirë gjatë pandemisë së Covid -19 janë organizuar mbledhjet e ETN –së online duke zbatuar rregullat. Gjatë mbledhjeve janë diskutuar sfidat dhe vështirësitë për raportimin e rasteve të dhunës në familje si dhe menaxhimi i tyre.

BASHKIA TROPOJË

Në vitin
2020

• 1 rast i
menaxhuar

Gjatë periudhës së pandemisë në **Bashkinë Tropjë** ka funksionuar MKR-ja me anë të komunikimit online me anëtarët e ETN-së si dhe grupeve të krijuara në rrjetet sociale. Më datë: 03.06.2020 është mbajtur mbledhja e MKR-së në sallën e Këshillit Bashkiak me pjesën më të madhe të anëtarëve gjithnjë duke respektuar rregullat e distancimit.

Më datë 05.06.2020 është mbajtur sërish mbledhje e GTN-së për një rast emergjent, i cili iu referua NJMF-së në Bashkinë Tropjë. Ndërkaq, për vitin 2019, koordinatoresha vendore nuk disponon të dhëna për rastet e dhunës në familje.

BASHKIA BULQIZË

Në vitin
2020

• 2 raste të
menaxhuara

Pavarësisht situatës së vështirë, gjatë pandemisë së Covid-19 në **Bashkinë Bulqizë** janë organizuar mbledhje online të ETN-së. Gjatë mbledhjeve janë diskutuar sfidat dhe vështirësitë gjatë kësaj periudhe, si rastet e dhunës në familje dhe menaxhimin e rasteve,

por dhe protokollet e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje ndërmjet MKR-së.

Në vitin
2019

• 2 raste të
menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) ka funksionuar dhe është mbledhur një herë gjatë periudhës së pandemisë Covid - 19. Koordinatorët vendorë kanë raportuar periodikisht pranë Komisionit të Barazisë Gjinore.

Për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje janë hartuar protokolle për funksionimin e MKR-së gjatë pandemisë. Me anë të këtij protokollit mundësohet nisja e procedurave në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që reagimi ndaj dhunës në familje të jetë i menjëhershëm dhe të operohet në kohë reale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

BASHKIA PËRMET

Në vitin
2020

• 0 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Përmet** janë hartuar protokollet për funksionimin e MKR-së nga Ministria e linjës dhe janë miratuar nga anëtarët e MKR-së, duke zbatuar masat për mbrojtjen e viktimave të dhunës. Këto protokolle përshkruajnë procedurën e funksionimit të MKR-së si gjatë pandemisë, edhe post pandemisë, që të operohet në kohë reale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe nisjen e procedurave në mënyrë të menjëhershme.

Në vitin
2019

• 2 raste të
menaxhuara

BASHKIA TEPELENË

Në vitin
2020

• 2 raste të
menaxhuara

MKR në **Bashkinë Tepelenë** ka funksionuar dhe është mbledhur 2 herë online gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Koordinatorja vendore ka raportuar periodikisht pranë KBGJ-së.

Në vitin
2019

• 1 rast i
menaxhuar

Për një nga rastet e dhunuara është ofruar strehim i përkohshëm nga Bashkia. Gjithashtu, për të dy Urdhrat e Menjëhershëm për Mbrojtje janë nisur procedurat, si dhe rastet janë referuar edhe pranë KBGJ-së në Këshillin Bashkiak.

BASHKIA MAT

Në vitin
2020

• 0 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Mat** nuk ka pasur takim të MKR-së, kjo për arsye se nuk ka patur rast për periudhën Mars –Maj 2020. Megjithatë, me specialiste të policisë dhe gjykatës ka patur kontakte të vazhdueshme telefonike për shkëmbimin e informacioneve për rastet e dhunës në familje.

Në vitin
2019

• 2 raste të
menaxhuara

BASHKIA RROGOZHINË

Në vitin
2020

• 9 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Rrogozhinë** më datë 17.6.2020 është organizuar takimi me Komitetin Drejtues të Dhunës në Familje për “Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Bashkërendimit të Punës për Referimin dhe Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”. Marrëveshja u realizua midis Bashkisë Rrogozhinë dhe Linjës së Këshillimit për Gra dhe vajza të dhunuara.

Në vitin
2019

• 4 raste të
menaxhuara

Urdhëri i Mbrojtjes është monitoruar 1 një herë në javë, duke bërë kontrole në banesë dhe duke biseduar çdo ditë me telefon gjatë periudhës Covid-19, nga koordinatori i dhunës në familje në bashkëpunim me koordinatorët e shërbimit social të njësive administrative të Bashkisë.

BASHKIA FIER

Në vitin
2020

• 27 raste të
menaxhuara

MKR në **Bashkinë Fier** është mbledhur rregullisht deri në shkurt të vitit 2020. Situata e shkaktuar nga Covid-19 ka ndikuar që ETN-në të mos mblidhet. Por, edhe pse mbledhja e Grupit Teknik nuk është bërë fizikisht, janë mbajtur kontakte të vazhdueshme telefonike në varësi të rasteve. Për periudhën

Në vitin
2019

• 38 raste të
menaxhuara

Janar-Prill 2020 janë menaxhuar 27 raste, ndërsa në vitin 2019 për të njejtën periudhë janë raportuar 38 raste të dhunës. Monitorimi i Urdhrave të Mbrojtjes nuk është kryer me vizita të drejtëpërdrejta në banesa, por nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm telefonik me viktimat/të mbijetuarit.

BASHKIA LIBRAZH

Në vitin
2020

• 0 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Librazhd** ETN-ja është mbledhur një herë online ku ka referuar koordinatorja vendore për situatën e rasteve të dhunës në familje.

Në vitin
2019

• 1 raste të
menaxhuara

BASHKIA CËRRIK

Në vitin
2020

• 16 raste të
menaxhuara

Funksionimi i Mekanizimit të Koordinuar të Referimit të Dhunës në Familje, ka qënë një nga sfidat disa vjeçare në Bashkinë Cërrik, duke qënë se është krijuar në vitin 2015, por vetëm vitet e fundit, janë bërë përpjekje për ta vendosur në veprim me efektivitet. Në këtë Bashki, rastet e dhunës janë menaxhuar dhe kanë marrë të gjitha shërbimet përkatëse.

Në vitin
2019

• 17 raste të
menaxhuara

BASHKIA PRRENJAS

Në vitin
2020

• 7 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Prrenjas** për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje është hartuar protokoli për funksionimin e MKR-së, gjatë dhe pas periudhës të pandemisë. MKR-ja ka qënë në funksion të rasteve të dhunës gjatë periudhës të Covid-19 dhe Koordinatorja Vendore, ka raportuar për situatën gjatë kësaj periudhe pranë Komisionit të Barazisë Gjinore.

Në vitin
2020

• 15 raste të
menaxhuara

Ndërkaq, vetëm 1 rast i dhunës në familje është pajisur me Urdhër Mbrojtje, i cili monitorohet në mënyrë periodike sipas procedurës ligjore.

BASHKIA SELENICË

Në vitin
2020

• 1 rast i
menaxhuar

Bashkia Selenicë e ka të ngritur dhe funksional Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të Dhunës, por MKR-ja nuk është mbledhur gjatë periudhës së karantinimit si pasojë e Covid-19. Gjatë periudhës janar-qershor 2020 është paraqitur vetëm një rast i dhunës në familje, ndërkaq, gjatë periudhës së karantinimit nuk janë paraqitur raste të dhunës. Për të njejtën periudhë në vitin 2019 janë menaxhuar 3 raste të dhunës në familje.

Në vitin
2019

• 3 raste të
menaxhuara

BASHKIA DEVOLL

Në vitin
2020

• 7 raste të
menaxhuara

Pranë **Bashkisë Devoll** është ngritur dhe funksionon ETN-ja. Për periudhën janar-korrik 2020 është marrë informacion i herëpashershëm me SPZ-të e zonave për denoncimet për rastet me UMM për viktimat e dhunës.

Në vitin
2019

• 6 raste të
menaxhuara

Po ashtu, është mbajtur kontakt telefonik me viktimat e dhunës për të marrë informacion në lidhje me situatën e krijuar në familje. Monitorimet janë kryer në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me SPZ-të e zonave. Për periudhën janar-korrik 2020, pranë Sektorit të Mirëqenies dhe Kujdesit Social, janë raportuar 7 UMM, nga të cilat katër raste janë raportuar gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 Ndërsa, për periudhën kohore Janar – Korrik 2019, janë raportuar 6 UMM.

BASHKIA POGRADEÇ

Në vitin
2020

• 8 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë Pogradec**, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit ka qenë në gatishmëri për të bashkërenduar punën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Gjatë periudhës së Covid-19, janë realizuar 3 takime online me qëllim organizimin e një plani individual për secilin rast të dhunës në familje. Të gjitha rastet e referuara, janë diskutuar në mbledhjen e grupit teknik, nga të cilat janë zhvilluar 3 mbledhje fizike duke respektuar protokollin e sigurisë në kuadër të Covid-19.

Në vitin
2019

• 24 raste të
menaxhuara

Në periudhën e Covid-19, ka patur 2 raste të dhunës në familje me urdhër mbrojtje për të cilat Koordinatori Vendor i dhunës në familje, bën raportimin sipas ligjit.

Gjatë periudhës mars-qershor 2020, janë raportuar 8 raste të reja të dhunës në familje. Këto raste janë referuar nga Komisariati i Policisë Pogradec. Vihet re që numri i rasteve të dhunës duke e krahasuar me periudhën me vitin e kaluar është më i ulët. Gjatë vitit 2019 për periudhën mars-qershor 2019 janë 24 raste.

Menaxhimi i të gjitha rasteve bëhet nga Koordinatori Vendor Kunder Dhunës në familje dhe Barazisë Gjinore. Të gjitha rastet janë ndjekur në kontakt të shpeshtë nëpërmjet telefonit me viktimat e dhunës në familje. Raportimi çdo 60 ditë i rasteve nuk ka ndodhur në këtë periudhë pandemie pasi shumica e rasteve të dhunës në familje janë nga zona e Mokrës dhe Njësive të tjera Administrative ku ka qënë i mbyllur transporti publik. Por kjo nuk e ka penguar punën tonë pasi kemi pasur kontakte të vazhdueshme dhe me Administratorin e Ndihmave Ekonomike në njësit administrative. Ky administrator shërben dhe si pikë kontakti për të gjithë personat që kërkojnë ndihmë sociale nga Bashkia e Pogradecit.

BASHKIA KUÇOVË

Në vitin
2020

• 3 raste të
menaxhuara

Në **Bashkinë e Kuçovës**, MKR është mbledhur katër herë gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19. Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur 3 raste me urdhër të menjëhershëm mbrojtje, kundrejt 4 rasteve në vitin 2019 për të njejtën periudhë.

Në vitin
2019

• 4 raste të
menaxhuara

BASHKIA KRUJË

Në vitin
2020

• 3 raste të
menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit funksionon që prej vitit 2015 dhe mblidhet rregullisht, ku trajtohen specifikisht të gjitha rastet duke mundësuar zgjidhje konkrete për familjet në vështirësi dhe konkretisht grave e vajzave viktimat të dhunës.

Në vitin
2019

• 3 raste të
menaxhuara

Për secilin nga rastet, përgatitet një raport i detajuar social nga administrata e Bashkisë dhe referohet tek MKR-ja. Gjatë kësaj periudhe mars -maj 2020 janë paraqitur 3 raste të dhunës në familje, shifër kjo e njejtë me të njejtën periudhë për vitin 2019.

BASHKIA FINIQ

Në vitin
2020

• 3 raste të
menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR), ka funksionuar dhe është mbledhur 2 herë gjatë kësaj periudhës së Covid-19. Koordinatorët vendorë kanë raportuar periodikisht pranë Komisionit të Barazisë Gjnore. Për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës në familje janë hartuar protokolle për funksionimin e MKR-së si gjatë pandemisë, edhe pas periudhës së pandemisë.

Në vitin
2019

• 3 raste të
menaxhuara

Me anë të këtij protokollit mundësohet nisja e procedurave në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që reagimi ndaj dhunës në familje të jetë i menjëhershëm dhe të operohet në kohë reale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjnore. Po ashtu, janë monitoruar dhe vazhdon në mënyrë periodike monitorimi i 2 urdhërave të mbrojtjes, sipas procedurës ligjore.

BASHKIA DURRËS

Në vitin
2020

• 247 raste të
menaxhuara

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR), ka funksionuar dhe është mbledhur 2 herë gjatë kësaj periudhës së Covid-19. Koordinatorët vendorë kanë raportuar periodikisht pranë Komisionit të Barazisë Gjnore. Për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje janë hartuar protokolle për funksionimin e MKR-së si gjatë pandemisë, edhe pas periudhës së pandemisë.

Me anë të këtij protokollit, mundësohet nisja e procedurave në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që reagimi ndaj dhunës në familje të jetë i menjëhershëm dhe të operohet në kohë reale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjnore. Po ashtu, janë monitoruar dhe vazhdon në mënyrë periodike monitorimi i 2 urdhërave të mbrojtjes, sipas procedurës ligjore.

Në periudhën janar-qershor 2020, janë regjistruar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës 247 Kërkesë Padi për lëshimin e UM dhe UMM.

- Janë lëshuar 311 vendime për UM dhe UMM nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

MKR është ngritur në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me fonde të Qeverisë Suedeze.

MKR ka funksionuar edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, në varësi të rasteve dhe të problematikave të hasura në çdo rast është bërë dhe kontaktimi më emergjent me aktorët bërthamë më të ngushtë për referimin, adresimin dhe ndjekjen e rastit nga ku janë alternuar dhe takimet në grup, në platformën ZOOM dhe nëpërmjet telefonit të tilla, si: Ëhatsapp.

Me mbështetjen e policisë, gjatë situatës së izolimit në periudhën e Covid-19, familjet në situatë dhune janë monitoruar vazhdimisht nga Bashkia dhe nga Policia.

Nëpërmjet numrit të gjelbër 08009888 janë mbështetur, kryesisht, rastet që kanë pasur nevoja të ndryshme për ndihmë, të tilla si: shërbime psikologjike, ligjore dhe informuese. Telefonatat për këshillim psikologjik e juridik kanë përfshirë ofrimin e mbështetjes psikologjike për të kapërcyer ndjenjat e ankthit, të pasigurisë, frikës, luhatjet emocionale dhe frikës për të ardhmen, etj.

Në rrjete sociale është bërë afishimi i informacioneve të vazhdueshme rreth situatës, mënyrave dhe masave mbrojtëse.

V. SFIDAT NË ADRESIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Në **Bashkinë Belsh**, gjatë periudhës së Covid-19, transporti për në Elbasan apo edhe marrja e shërbimeve të tjera ka paraqitur vështirësi. Mungesa e fondeve ka bërë që shërbime apo edhe mjetet bazike të nevojshme për të operuar gjatë Covid-19 të siguroheshin nga vetë punonjësit. Punonjësit pothuajse nuk kanë patur asnjë mbështetje për mjetet mbrojtëse dhe transportin, për të kryer normalisht punën e tyre.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme që të ketë fonde të veçanta për emergjencën në mënyrë që punonjësit e Bashkisë apo edhe punonjësit, që janë në vijën frontale të gatishmërisë, të jenë të mbrojtur dhe të mbështeten për të kryer punën maksimalisht.

Disa nga sfidat e hasura në menaxhimin e rasteve të dhunës në **Bashkinë Shkodër** dhe të raportuara nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Shtrehimit dhe Shëndetit janë:

- **Gjetja e kontakteve të rasteve të dhunës në familje**, pasi në vendimet gjyqësore mungojnë kontaktet e individëve, gjë që vështirëson dhe krijon një hendek kohor me vënien në kontakt me rastin.
- **Vonesa kohore për dërgimin e UMM-ve.** Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 dërgimi i UMM-ve dhe UM-ve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vazhduar, por me vonesa kohore dhe jo në mënyrë të rregullt.
- **Vështirësi në menaxhimin e rasteve për shkak të kufizimeve të marra në kuadër të pandemisë COVID-19:**

- sigurimi i shërbimeve të nevojshme në varësi të nevojave specifike të rastit;
- përgjigjia dhe besueshmëria e telefonatave të realizuara me rastet në mungesë të vizitave ballë për ballë, e bën të vështirë krijimin e empatisë dhe besueshmërisë.

Sfidat dhe problematika, që mbarten në **Bashkinë Delvinë** të raportuara nga zyra e Shërbimeve Sociale, përsa i përket trajtimit të rasteve të dhunës në familje janë:

- **Mungesë në burime njerëzore në administratë** të punonjësve socialë dhe psikologëve;
- **Nevoja për buxhet të dedikuar** për shërbime dhe programe mbështetëse për rastet e dhunës në familje.

Për **Bashkinë Kolonjë**, shërbimet e ofruara nuk janë të plota për shkak të buxhetit të kufizuar. Policia e shtetit është subjekt i sigurt për adresimin e dhunës, por nga ana tjetër nuk ka menaxhim të mirë përsa i përket ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje. Fokus grupi solli një rast konkret të mos ruajtjes së të dhënave për një rast të dhunës në familje dhe ku i gjithë komuniteti arriti të mësonte detaje rreth rastit.

Në **Bashkinë Gjirokastrë**, gjatë diskutimit në fokus grup, punonjësit, sidomos ata të njësive administrative, janë përkushtuar maksimalisht madje dhe me orare të zgjatura, duke patur parasysh situatën e pafavorshme në të cilën mund të gjendeshin viktimat e dhunës. Por, ka patur nevoja përsa i përket mjeteve mbrojtëse si maska apo doreza të cilat shpesh punonjësit i kanë siguruar vetë. Gjithashtu, ka patur kosto dhe shpenzime më shumë se normalisht, sidomos në vizitat në terren, të cilat punonjësit i kanë mbuluar nga shpenzimet vetjake.

Monitorimi i zbatimit të Urdhrave të Mbrojtjes në **Bashkinë Kukës** ka paraqitur sfidë gjatë periudhës së pandemisë. Monitorimi i tyre është kryer në bashkëpunim me punonjësit e policisë. Raportet e monitorimit janë përgatitur për secilin rast dhe nuk ka patur shkelje të urdhrave të mbrojtjes.

- Një nga problematikat e vërejtura ka qenë se pas përfundimit të afatit të Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, disa prej viktimave nuk janë paraqitur për verifikimin e urdhrit të mbrojtjes duke u tërhequr nga kërkesa për urdhër mbrojtje me arsyetimin se i kemi "sheshuar problemet". Këto raste kanë paraqitur vështirësi për t'u monitoruar pasi ka mungesë të bazës ligjore dhe është proceduar duke mbajtur kontakte telefonike për t'u informuar për situatën pas-urdhër mbrojtjes.

Në njësitë administrative të **Bashkisë Pogradec** pikë kontakti është administratori i Ndihmave Ekonomike, i cili gjithashtu referon në Bashki rastet e dhunës që paraqiten për ndihmë.

Është vënë re vonesë në marrjen e shërbimit dhe në adresimin e rasteve në Njësitë Administrative, pasi në fshat për shkak të komunitetit të vogël, gratë e dhunuara stepen të flasin për problemin. Ndaj, në të shumtën e rasteve adresimi bëhet kur situata është në nivele të rrezikshmërisë së lartë.

Të gjitha rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore janë adresuar nga Policia e Shtetit. Kjo nënkupton që **identifikimi i rasteve është bërë në fazën kur ato kanë qënë të agravuara.**

Shërbimi social në Njësitë Administrative është i organizuar vetëm nga një punonjës i cili merret kryesisht me ndihmat ekonomike, por që është i autorizuar për të adresuar dhe çdo çështje sociale, përfshirë këtu edhe ato të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Gjatë zhvillimit të fokus grupi në **Bashkinë Bulqizë** nga punonjës të administratës të zonave administrative theksohet:

- **Dhuna është e pranishme në çdo familje,** sidomos në ato fshatra të thella ku kushtet ekonomike, mendësia patriarkale e kultura familjare luajnë rol kryesor në ushtrimin e dhunës dhe pranimin e dhunës.
- **Shumë gra janë të dhunuara, por kanë frikë dhe ndihen të turpëruara** nëse do ta bëjnë publike dhunën në familje. Siguria e jetës së tyre do vihej në rrezik nëse do bëhej publike.
- **Pamundësia për të përballuar jetesën për shkak të divorcit i bën gratë dhe vajzat të heshtin para dhunës.** Gjithashtu, mos informimi i grave dhe vajzave për çështjet e dhunës dhe se si ato mund të mbrohen, ndikon që gratë dhe vajzat ta shohin dhunën si një pjesë të jetës së tyre të përditshme.

Në **Bashkinë Tropojë** ka vetëm një nëpunës për barazinë gjinore në strukturën e saj, por ndër të tjera ky punonjës është i ngarkuar edhe me funksione të tjera dhe një ndër detyrat që kryen ky punonjës është ndjekja e rasteve të dhunës.

Në fokus grupin e zhvilluar në **Bashkinë Poliçan** theksohet se mësuesit preferojnë të zgjidhin vetë situatat me fëmijët në vend që t'i drejtojnë ata tek psikologu.

- **Mungesa e informimit dhe e raportimit të dhunës në familje në mjediset e shkollës:** Shpeshherë fëmijët shprehen për raste dhune në familjet e tyre, por mësuesit i këshillojnë të mos flasin, për t'i mbrojtur nga paragjykimi i bashkëqytetarëve. Ndërkohë,
- **Frika e grave që janë viktimë e dhunës për të denoncuar:** Qendra Shëndetësore ka referuar raste, por përballë një pasigurie, varfërie dhe frike, gratë viktimat të dhunës kanë preferuar të mos denoncojnë.

Për **Bashkinë Vlorë** është identifikuar si sfidë gjatë Covid-19:

- **Mungesa e burimeve njerëzore** në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Në Bashkinë qendër, po ashtu edhe në njësitë administrative ka vetëm nga 1 Administrator Social, i cili merret kryesisht me ndihmën ekonomike dhe asistencën sociale.

- **Mungesë e shërbimeve alternative.** Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Vlorë është shumë bashkëpunuese me të gjithë aktorët e tjerë, por shërbimet e saj të drejtperdrejta janë të limituara. Bashkia mund të ofrojë vetëm trajtim me ndihmë ekonomike të viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje, trajtim falas të fëmijëve të tyre dhe trajtim me bonus qeraje për këto viktime.

Në **Bashkinë Roskovec** sfidat janë hasur në lidhje me strukturat e policisë dhe median:

- **Policia e shtetit** mbetet një partnere dhe subjekt i sigurt për t'u adresuar, por nuk ka përditësuar ndryshimet e reja të kuadrit ligjor, lidhur me rastet e vlerësimit të riskut dhe kjo çon në vlerësime jo të sakta të rasteve.
- **Media**, kryesisht ajo sociale, ndikon negativisht duke çuar në hezitimin e viktimave të dhunës për denoncimin e dhunës, pasi në shumë raste, të cilat u përmendën gjatë diskutimit të fokus grupit, informacione të ndjeshme janë keqpërdorur për të krijuar 'lajm' dhe jo për t'iu ardhur në ndihmë viktimave të dhunës apo për të ndimuar në funksionimin e MKR-së.

Të dhënat e grumbullura nga fokus grupi i zhvilluar në **Bashkinë Peqin** theksojnë se gjendja ekonomike dhe edukimi janë faktorët kryesor për dhunën në familje. Papunësia dominon në këtë qytet të vogël, pasi mungojnë subjektet private për punësim. Sfida dhe problematika për menaxhimin e rasteve të dhunës hasen në çdo kohë, por këto sfida dolën në pah edhe më shumë gjatë Covid-19, të tilla si:

- **Mungesa e informacionit:** Nga bisedat me pjesëmarrësit në zonat e thella rurale mungon informacioni i duhur për t'u drejtuar në strukturat e duhura për të adresuar dhunën.
- **Mungesa e shërbimeve ndaj viktimave të dhunës:** Për gratë dhe vajzat e dhunuara nuk ka një qendër multifunksionale ku të marrin të gjitha shërbimet e duhura.
- **Mungesë të burimeve njerëzore të specialistëve në administratë** për të trajtuar rastet e paraqitura.
- **Tërheqja denoncimeve për rastet e dhunës:** Nga të dhënat e grumbulluara nga fokus grupi, mendësia patriarkale vështirëson identifikimin e rasteve të dhunës dhe tërheqjen e denoncimeve.
- **Mungesa e fondeve:** Bashkia nuk ka fonde për të parandaluar apo trajtuar rastet e dhunës në familje.

Për shkak se MKR-ja në **Bashkinë Shijak** nuk ka funksionuar plotësisht, Koordinatori Vendor ka hasur vështirësi dhe problematika për shkak të mungesës së kontaktit midis anëtarëve të ETN-së. Për këtë shkak nuk ka qenë e mundur të kontaktohen viktimat e dhunës në familje, që më pas të plotësohej raporti për monitorimin e urdhërit të mbrojtjes.

Në **Bashkinë Fier** është hasur si sfidë mungesën e një qendre emergjence. Ndaj, rasteve të dhunës iu është dhënë strehim afatshkurtër në Qendrën e Emergjencës Roskovec.

Edhe pse në **Bashkinë Mirditë** ende nuk është ngritur Mekanizmi Kombëtar i Referimit, gjatë pandemisë Covid-19 ka pasur një bashkëpunim efektiv midis institucioneve, si Policia, Njësitë vendore, institucionet arsimore, shëndetësore, Dioqeza dhe Organizata jo qeveritare.

- Nga ana e e shërbimeve sociale janë bërë përpjekje pozitive, por haset **vështirësi në identifikimin në faza të hershme të rasteve të dhunës për shkak të mungesës së MKR-së.**

Gjatë fokus grupit të zhvilluar në **Bashkinë Gramsh** u identifikuan disa faktorë që ndikojnë në denoncimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- **mungesa e të ardhurave**, pra e një pavarësie ekonomike të grave;
- **frika ndaj paragjykitit të bashkëqytetarëve.**

Gjatë diskutimit me fokus grupin si edhe me punonjësit e **Bashkisë Libohovë** u theksua fakti që ekzistojnë disa barriera për mos raportimin e dhunës:

- **Paragjykimi dhe mendësia** për të toleruar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
- **Mungesa e pavarësisë ekonomike**, e cila mbetet një problem serioz dhe kushtëzon gratë të jetojnë në të njejtin mjedis/shtëpi me dhunuesit, pasi nuk kanë ku të drejtohen.
- **Mungesa e një qendre për mbështetje psikologjike.**

Për sfidat e paraqitura më sipër gjatë takimit të fokus grupit u sugjerua:

- Një bashkëpunim i ngushtë me median lokale për të rritur ndërgjegjesimin dhe luftën ndaj dhunës në familje, si dhe për të nxitur gratë të drejtohen drejt autoriteteve lokale.
- Forcimi i mbështetjes nga ana e Bashkisë përmes realizimit të nismave dhe projekteve.
- Dhënia e mbështetjes për bizneset që punësojnë gra dhe në veçanti ato në nevojë, duke hartuar politika për lehtësimin e taksave.
- Ndërtimi i një qendre multifunkionale për gratë, vajzat dhe fëmijët e dhunuar.

Në **Bashkinë Kamëz** për trajtimin e rasteve të dhunës në familje gjetjet e fokus grupit paraqesin disa faktorë që ndikojnë në sfidat për të trajtuar rastet e dhunës:

- **Mungesa në burime njerëzore dhe logjistike** duke bërë që shërbimet e ofruara të jenë vetëm mbështetëse. Për rrjedhojë, **institucionet vendore kanë mungesë stafi, mungesë të shërbimit psikologjik si dhe mungesë buxheti.** Koordinatorja për dhunën në familje punon me orare të zgjatura dhe numri i lartë i denoncimeve ul mundësinë për t'iu ofruar shërbimin të gjithë personave që kanë nevojë duke marrë në trajtim në të shumtën e rasteve vetëm situatat me nivel të lartë rrezikshmërie.

- **Pamundësia për të përballuar të gjitha rastet** nga qendra ekzistuese për mbrojtjen ndaj dhunës.
- **Faktorët ekonomikë:** Mungesa e një stabiliteti ekonomik dhe papunësia.
- **Faktorë socialë dhe kulturorë:** Mendësia patriarkale për të pranuar dhunën dhe hezitimi për ta denoncuar dhunën, e cila është thelluar edhe më shumë gjatë Covid-19. Kamza ka një heterogjenitet kulturash dhe martesat midis “kulturave të ndryshme” sjellin mosmarrëveshje në familje dhe si pasojë bëhen shkak për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.
- **Bashkërendimi i ofrimit të shërbimeve** nga ana e institucioneve përgjegjëse për specifikimin e shërbimeve që Bashkia ofron kundrejt viktimave të dhunës. Bashkëpunimi institucional si dhe bashkëpunimi me Organizatat jo-fitimprurëse është i ngushtë, pasi institucionet kanë nevojë për mbështetjen ekonomike që organizatat ofrojnë, pa të cilat nuk ka menaxhime të rasteve, pasi janë këto të fundit që ofrojnë shërbimet. Këto shërbime përfshijnë: transportin e viktimave/të mbijetuarve nga njëri institucion në tjetrin, ofrimin e paketave ushqimore, pagesat e qerave në kushte emergjence, veshmbathje në kushte emergjence, etj.
- **Roli negativ i medias** përsa i takon qasjes me rastet e dhunës duke dëmtuar psikologjikisht viktimat/të mbijetuarit dhe publikuar të dhëna personale rreth rastit, dhe shpeshherë duke vështirësuar institucionet vendore në realizimin e punës.
- **Riviktimizimi**, një sfidë që mbetet ndër më të vështirat ku shpeshherë viktimat e dhunës në familje qëndrojnë në ‘rolin e tyre si të dhunuar’ dhe e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë dhe të përmirësojnë jetën e tyre.

Në **Bashkinë Klos** raportohet që nuk ka organizatë që të ofrojë mbështetje konkrete për viktimat e dhunës në familje. Shoqata “Argita Vizion”, e cila ndodhet në Dibër, është e vetmja shoqatë që ofron strehim emergjent, krahas këshimit ligjor dhe psikologjik. Strehim afatshkurtër ofrohet nëpërmjet shoqatës “Argita Vizion” në Dibër.

Gjatë fokus grupit të zhvilluar në **Bashkinë Pustec** u theksua se gratë apo fëmijët e kësaj zone edhe në rast të referimit të dhunës, përveç Urdhërit të Mbrojtjes, nuk gjejnë mbështetje tjetër. Kjo vjen si pasojë e një sërë faktorësh:

- **mungesë e buxhetit për trajtimin e rasteve të dhunës;**
- **mungesë e një psikologu(eje) në stafin bashkiak;**
- **mungesë e një programi për ndërgjegjësim dhe sigurimin e punësimit.**

Në **Bashkinë Cërrik** nuk ka një qendër për strehimin e menjëhershëm të viktimave/të mbijetuarve nga dhuna në familje, por këto raste strehohen në Elbasan. Bashkia Cërrik në kuadër të mbështetjes së strehimit afatgjatë, ka mbështetur strehimin e viktimave/të mbijetuarve nga dhuna në familje me bonus qeraje dhe me mundësinë e kredive të buta.

Një nga sfidat që u përmend gjatë diktimit në fokus grup ka qënë në lidhje me **shërbimin shëndetësor** dhe me **mungesën e hallkave të rëndësishme të referimit dhe parandalimit në shkollë**, siç janë punonjësit socialë dhe psikologët.

Mungesa e psikologëve dhe punonjësve socialë në shkollë ka qënë një nga problematikat kryesore të ngritura gjatë fokus grupit dhe adresimi i menjëhershëm i kësaj problematike nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, ka rezultuar si një nevojë emergjente përse i përkete trajtimit dhe menaxhimit të rasteve të dhunës.

Për **Bashkinë Korçë** çështje të cilat paraqesin sfida edhe gjatë periudhës së Covid-19 janë:

- **Transporti dhe shoqërimi i viktimave/të mbijetuarve** për të kryer shërbimet e nevojshme në institucione të ndryshme si qendër shëndetësore, komisariat, etj. Aktualisht, viktimat shoqërohen me makinën e policisë, por kjo nuk është pozitive pasi tërheq vëmendje dhe mund të krijojë vështirësi për viktimën/të mbijetuarit. Fondi specifik emergjent mund të krijojë hapësirën për ofrimin e një transporti më të personalizuar.
- **Shërbimi emergjent për viktimat e dhunës në familje** do të ishte shumë i vështirë pothuaj i pa mundur pa ndihmën e organizatave partnere. Kjo pasi fondet dhe burimet njerëzore janë të pamjaftueshme për mbulimin e shërbimit psiko-social dhe ndihmës së drejtpërdrejtë për përfituesit.
- **Raportimi në qendrat shëndetësore.** Vështirësi duket se ka në qendrat e shëndetësore sidomos në njësitë administrative. Rastet raportohen kryesisht nga kryepleqtë, ndërkohë që mjekët e familjes apo edhe infermierët mund të bëjnë më shumë për identifikimin e rasteve.
- **Funksionimi i shërbimit psikosocial.** Shërbimi psikosocial funksionon në nivelin e shërbimit spitalor, por jo në qendrat shëndetësore sidomos të njësive administrative.

Bashkia Durrës ka hasur disa sfida për trajtimin e rasteve të dhunës gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19:

Menaxhimi i rasteve të dhunës kur:

- dhunuesi/ja është fëmijë.
- personi që ëshët marrë në mbrojtje është njëkohësisht edhe i/e dhunuar edhe dhunues/e.

Mungesa e strehimi afatmesëm dhe afatgjatë përbën një sfidë për shërbimin social, po ashtu dhe për të gjithë mekanizmin duke përfshirë edhe Bashkinë.

Mungesa e programeve për mbështetje financiare për nënat me fëmijë të vegjël dhe që nuk janë të punësuar. “Shoqata e Grave me Probleme Sociale” thekson se fuqizimi ekonomik i grave mund të arrihet nëpërmjet programeve të punësimit në mënyrë që të ketë impakt në rritjen e pavarësisë ekonomike të grave të dhunuara.

Referim në kohë të rasteve nga Policia e shtetit: Ndryshimet e reja ligjore kërkojnë tjetër vëmendje. Policia në momentin që vjen rasti, duhet të njoftojë në kohë reale koordinatorin vendor për të bërë edhe ato një vlerësim të çdo rasti të nivelit të rrezikut dhe këto të fundit, kanë përgjegjësinë për ta referuar tek mekanizmi i gjithë sistemit të nevojshëm në bazë të nivelit të vlerësimit të riskut që do të bëjë specialistja.

Saktësim dhe plotësim të të dhënave në vendimet e Gjykatës: Hedhja e informacioneve në Sistemin REVALB bllokohet në momentin që vendimet e Gjykatës nuk kanë të dhëna të sakta dhe të plota mbi gjeneralitetet.

Nga ana e Policisë së Shtetit paraqiten disa sfida:

Qëndrimi në të njëjtën banesë i viktimës dhe dhunuesit(es), që çon në rritje të rrezikshmërisë, të presioneve dhe deri në humbje jete.

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve të pastrehë. Gjatë 6 muorit të fundit është shtuar numri i rasteve të fëmijëve të pastrehë, që vijnë kryesisht edhe nga qyteti i Elbasanit dhe Fierit. Pas situatës së tërmetit janë parë të strehohen nën ura dhe në pallate të braktisura që paraqesin rrezikshmëri të lartë për banim.

Për “Eorl Vision” situata paraqitet sfiduese në disa raste:

Reagimi nga Gjykata dhe Prokuroria: reagimi dhe masat e marra nga personeli i drejtësisë tregojnë që ato nuk janë të njohur me të gjithë punën e jashtëzakonshme të institucioneve bashkiake dhe OJF-ve. Dhe kjo vihet re **në mungesën e iniciativës** për t’u njohur me secilin prej profileve të rasteve të dhunës në familje duke rrezikuar në këtë mënyrë trajtimin e duhur të rastit. Kjo është më e dukshme në rastet kur:

- Vendimi jepet që gruaja të largohet nga shtëpia dhe jo dhunuesi;
- Vendimi jepet për heqjen e të drejtës prindërore dhe marrjet e kujdestarisë.

Edhe në takimin e ETN-së nuk kishte të pranishëm asnjë përfaqësues nga institucioni i Gjykatës pasi ishin me pushime) dhe nuk e kishin konsideruar mundësinë e delegimit.

Drejtuesja e Qendrës së Emergjencës thekson se kërkohet një mbështetje nga Policia dhe Gjykata për të rritur sa më shumë bashkëpunimin dhe funksionalitetin e qendrës.

Ndërkaq, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës ngre shqetësimin për:

- **Referim i rasteve të dhunës nga drejtorja e shërbimit publik.** Mjekët e familjes nuk kanë referuar asnjë rast të dhunës në familje. Këta të fundit janë një nga aktorët kyç në adresimin e dhunës dhe duhet të jenë po aq të përfshirë sa pjesa tjetër e organizmit.

Gjatë periudhës së pandemisë në **Bashkinë Kuçovë** janë hasur vështirësi në trajtimin e rasteve të dhunës në:

- **Mungesë të burimeve njerëzore të specialistëve në administratë** për të trajtuar rastet e paraqitura.
- **Lëvizjen e vazhdueshme të punonjësve në administratë.**
- **Mungesë të buxhetit të dedikuar për rastet e dhunës dhe mungesa e politikave konkrete për mbështetjen e këtyre rasteve.**
- **Mungesë të një qendre multifunkionale** për të trajtuar rastet e paraqitura të dhunës.

Në **Bashkinë Kurbin** grupet e interesit gjatë zhvillimit të fokus grupit theksuan rëndësinë për vëmendje të shtuar ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe në veçanti:

- **Ruajtja e të dhënave personale të rasteve të dhunës në familje** ishte dhe një nga problematikat e identifikuar. Një komunikim për ruajtjen e të dhënave personale dhe të ndjeshme do të nxiste edhe më shumë besimin tek strukturat e policisë dhe shtetit/shërbimit.

Për **Bashkinë Rrogozhinë** nga zhvillimi i fokus grupit u evidentuan disa sfida të hasura gjatë pandemisë Covid-19 përsa i përket shërbimeve të ofruara për adresimin e dhunës në familje:

- **Mungesë një buxheti specifik** për menaxhimin e rasteve të dhunës;
- **Mungesë e një sistemi logjistik për transportit** e viktimave/ të mbijetuarve në Gjykatë apo drejt një vendi më të sigurtë;
- **Mungesë e një qendre strehimi të emergjencës për 72 orë**, mungesë e cila bën që në të shumtën e rasteve viktimat të përballen me një risk më të lartë të ushtrimit të dhunës ndaj tyre.
- **Mungesë e një psikologeje në qendrën e policisë**, e cila konsiderohet si shumë e domosdoshme për t'i dhënë mbështetje psiko-sociale viktimave/të mbijetuarve të dhunës.

Problematikat që janë hasur në **Bashkinë Prrenjas** përsa i përket trajtimit të dhunës në familje gjatë pandemisë Covid-19.

- **Mungesë në burime njerëzore për punonjës socialë dhe psikologë** në administratë;
- **Mungesa e buxhetit të dedikuar** për shërbime dhe programe mbështetëse për të trajtuar rastet e dhunës;
- **Mungesa e një qendre multisociale dhe profesionale** për gratë dhe vajzat e dhunuara.
- **Mungesa e qendrës së emergjencës për rastet e dhunës**. Një nga rastet e dhunës është strehuar në qendrën e “Forumit të Gruas” në Elbasan për 24 orë.

Në **Bashkinë Selenicë** ka një bashkëpunim të mirë ndërinstitutional midis Bashkisë dhe institucioneve që janë pjesë e MKR-së.

- Por, vihet re **mungesë e organizatave të shoqërisë civile dhe medias lokale** që punojnë për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore në Selenicë;
- Si rrjedhojë, edhe **shërbimet për rastet e dhunës janë më të kufizuara**. Drejtoria e shërbimit social në Bashki mund të ofrojë vetëm trajtim me ndihmë ekonomike për rastet e dhunës, këshillimit psikologjik për fëmijët e tyre dhe trajtim me bonus qeraje viktimat/të mbijetuarit;
- **Ushtrimi i dhunës ndaj personave të moshës së tretë** sipas aktorëve në fokus grup është një problematikë e cila duhet parë me prioritet në këtë Bashki;

- Mungesa e informacionit dhe e besimit në zonat rurale për shërbimet për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore;
- **Programet dhe shërbimet e ofruara nga institucionet nuk janë afatgjata apo të mjaftueshme** për të siguruar jetesën në vazhdim të viktimave/të mbijetuarve të dhunës. Për këtë arsye viktimat hezitojnë të raportojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre.
- **Mungesë e besimit nga viktimat ndaj ndihmës që ofrojnë shërbimet** dhe për shkak të frikës së paragjykitimit nga komuniteti, por edhe për shkak të gjykitimit të vet viktimës bën që numri i denoncimeve të rasteve të dhunës të jetë më i madh në krahasim me ato që janë denoncuar.

Problematika që janë hasur në **Bashkinë Finiq** përsa i përket trajtimit të rasteve të dhunës gjatë pandemisë së Covid-19 janë:

- **Mungesë në burime njerëzore** në administratë të punonjësve socialë dhe psikologë.
- **Nevoja për buxhet të dedikuar** për shërbime dhe programe mbështetëse.
- **Mungesa e një qendre multisociale dhe profesionale** për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe të papuna.

Sfida të tilla janë identifikuar edhe gjatë fokus grupit duke përfshirë shpejtësinë për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës, për shkak të mungesës së një ekipi profesionistësh të mirëfilltë për të ndjekur nga afër rastet e dhunës, si edhe buxheti i pamjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve.

Në **Bashkinë Roskovec** është ngritur strehëza e emergjencës që prej vitit 2018 dhe janë strehuar 5 raste, por gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 nuk është strehuar asnjë rast.

Gjatë takimit me anëtarët e fokus grupit në **Bashkinë Devoll** u theksua se **rastet e dhunës në familje, në realitet, janë në numër më të madh, se sa ato të denoncuar**. Si rezultat i mendësisë, shumë prej tyre bashkëjetojnë me dhunën. Për këtë arsye është e vështirë për të identifikuar dhe adresuar rastet e dhunës në familje.

Mungesa e banesave ose shtëpive sociale për rastet dhunës në familje. Disa nga rastet e dhunës adresohen për strehim në qytetin e Korçës.

VI. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR KOORDINIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Bashkia Shkodër ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit në vitin 2017, për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës, me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup.

- Në saj të kësaj marrëveshjeje *Bashkia bashkërendon punën për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare*. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë. Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare "Për Familjen", pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.
- Bashkia e Shkodrës ka një traditë të *bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile*. Një nga objektivat e saj është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në vazhden e traditës së mirë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile, Bashkia Shkodër ka bashkëpunuar ngushtë edhe me organizatat ndërkombëtare të tilla si: UNDP DHE UNËOMEN, si dhe organizata të tjera si: organizata "Gruaja te Gruaja", "Gruaja në Integrim", "Terre Des Hommes Albania", "Hapat e Lehtë", "Albanian Disability Rights Foundation", "Papa Giovanni XXIII", "Eorld Vision", "Nisma për Ndryshim Shoqëror", "Hope for the Eorld", "Gender Alliance for Development Center" për çështjet e dhunës me bazë gjinore. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i qendrave komunitare "Për familjen" të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.
- Krahas *aktiviteteve fushatat e komunikimit online me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit* për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19, janë shpërndarë postime me informacionin e nevojshëm se ku mund të kërkohet ndihmë dhe kontaktet e nevojshme.

Nga takimet me këshilltaret bashkiake, por kryesisht në takimin e fokus grupi, doli në pah bashkëpunimi korrekt dhe profesional në ndihmesë të rasteve të referuara nga institucionet vendore dhe qendrore.

- Angazhimi i të gjithë stafit të shërbimit social në Bashki dhe pranë njësive administrative, në ndjekje të rasteve të dhunës dhe dhënies së ndihmës nga psikologë dhe punonjës socialë.

- Mbulim profesional dhe trajtim i rasteve të dhunës nga specialistët e OJF, si “Gruaja tek Gruaja” (strehëza), asistencë ligjore dhe ndihmë ekonomike nga Qendra e Gruas “Hapat e Lehtë”, strehim, krijim i mjedisve për karantinim, mundësi integrimi për gratë dhe vajzat e dhunuara nga “Komuniteti Papa Xhovani 23”.
- Trajtim afatgjatë për gratë dhe vajzat e dhunuara, qendër rezidenciale me kapacitet deri në 15 persona (shtëpi mikpritëse Santa Maria).

Bashkëpunimi ndërinstitutional në **Bashkinë Cërrik** për ofrimin e shërbimeve në kushtet e COVID-19, referuar dhunës në familje ka qënë shumë i mirë. Bashkëpunimi me strukturat e shërbimeve sociale, me policinë e shtetit, me organizatat jofitimprurëse dhe me median ka qënë efektiv.

Në **Bashkinë Pogradec** bashkëpunimi institucional i aktorëve të përfshirë në proces ka qënë i mirë. Nga ana e përfaqësuesit të policisë u sugjerua që të përfshiheshin më shumë institucionet shëndetësore pasi të gjitha rastet e adresuara gjatë kësaj periudhe ishin nga policia e shtetit. Përfaqësuesi i policisë së shtetit u prononcua që ka patur të paktën 2 raste dhune të cilat janë paraqitur në ambulancë, por që denoncimi është bërë nga viktimat, nuk është referuar nga institucioni shëndetësor.

Gjithashtu, kërkohet për bashkëpunim më të ngushtë me Zyrën e Punësimit me qëllim përfshirjen e këtyre grave në programet e formimit profesional apo në ato të nxitjes së punësimit, me qëllim fuqizimin ekonomik të tyre.

Bashkia Maliq për monitorimin e Urdhrave të Mbrojtjes ka bashkëpunuar me bashkitë e tjera ku viktimat/ të mbijetuarit e dhunës në familje janë rezidentë dhe ka referuar rastet përkatëse.

Po ashtu, Bashkia ka ofruar shërbime me të gjitha institucionet e Bashkisë për identifikimin dhe shërbimet e domosdoshme ndaj rasteve të dhunës në familje. Në fokus grup u theksua bashkëpunim midis bashkisë dhe kryepleve të fshatrave, të cilët kanë identifikuar familjet në risk për dhunë në familje.

Me ngritjen e MKR-së në **Bashkinë Bulqizë** ka një bashkëpunim të mirë midis institucioneve. Institucionet pjesë e MKR-së kanë marrë pjesë në çdo takim, ku është diskutuar menaxhimi i rasteve, mënyra e denoncimit të tyre, si dhe janë ofruar shërbimet e nevojshme sipas rastit.

Për rastin e dhunës në familje (zona administrative Shupenzë), nga institucionet përgjegjëse të Bashkisë është dhënë në mënyrë të menjëhershme ndihma e duhur për shërbimet psiko-sociale, mjekesore dhe ushqimore.

Në **Bashkinë Delvinë**, pas marrjes së informacionit, specialistët e çështjeve sociale në Bashki hapin dosje dhe rastet shqyrtohen për të gjetur zgjidhje sipas nevojave dhe më pas referojnë pranë KBGJ në Këshillin Bashkiak. Gjatë zhvillimit të fokus grupit u diskutua që ky bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitutional të konkretizohet në një marrëveshje zyrtare. Kryetarja e Bashkisë sugjeroi organizimin e një forumi me pjesëmarrjen e Bashkisë, Policisë,

Shëndetësisë dhe Arsimit në zonë për ndërgjegjësimin e komunitetit për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

Për **Bashkinë Krujë** bashkëpunimi institucional ka rezultuar i suksesshëm duke u gjendur në kohë reale pranë grave dhe vajzave viktime nëpërmjet bashkëpunimit të pushteti vendor, policisë së shtetit, zyrës arsimore, OJF-ve dhe komuniteteve fetare.

Administrata e **Bashkisë Prrenjas** për trajtimin e rasteve të dhunës në familje ka bashkëpunuar me policinë, gjyqësorin dhe spitalin. Ndërkaq, për një nga rastet e dhunës asistencë ligjore është dhënë pa pagesë nga “Forumi i Gruas” në Elbasan.

Por, aktorët që morrën pjesë në fokus grup parashtruan rezerva për bashkëpunimin ndërinstitutional, duke theksuar se nuk është në nivelin e duhur. Kjo për shkak të mungesës në burimet njerezore të specializuara në Polici dhe në Bashki, duke u shprehur se për rastet e dhunës, gjë që pengon që të veprohet në kohë për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës.

Bashkia Vlorë bashkëpunon me qendrën “Vatra” për të ofruar shërbimin e strehimit të viktimave/ të mbijetuarve të dhunës në familje.

Në **Bashkinë Kukës** janë ndërmarrje nismat e mëposhtme për të trajtuar rastet e dhunës në familje:

- **Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis institucioneve** pjesë e Mekanizmit të Koordinimit të Referimit. Është përgatitur një marrëveshje nga Komisioni i Barasisë Gjinore, për të bashkëpunuar me një hotel, për të asistuar rastet e strehimit emergjent të viktimave të dhunës. Kjo marrëveshje do t’i propozohet për miratim Këshillit Bashkiak.
- **Miratimi i protokolleve të punës** për marrjen e masave në mbrojtje të viktimave të dhunës. Bashkia e Kukësit nëpërmjet Komitetit Drejtues, i cili drejtohet nga Kryetari i Bashkisë dhe anëtarët e ETN-së, është e para që ka miratuar këto protokolle pune më 09 qershor 2020.

Në **Bashkinë Mirditë** gjatë periudhës së Covid-19 janë bërë përpjekje serioze për bashkëpunimin dhe këmbimin e informacionit nga drejtoritë brenda Bashkisë si dhe institucionet, si policia, organet e drejtësisë dhe biznesi. Edhe pse në Bashkinë Mirditë ende nuk është ngritur Mekanizmi Kombëtar i Referimit, gjatë pandemisë ka pasur një bashkëpunim efektiv midis institucioneve, si policia, njësitë vendore, institucionet arsimore, shëndetësore, Dioqeza dhe organizata jo qeveritare.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile ka rezultuar efektiv në **Bashkinë Kurbin**. Organizatat si Eorid Vision dhe Kryqi i Kuq kanë databazë me familjet që jetojnë me minimumin jetik si dhe rastet e dhunës në familje. Gjithashtu, këto dy organizata kanë një

eksperiencë të gjatë duke u ofruar ndihmë rasteve dhe mbështetur gratë me bonuse qeraje dhe mundësi punësimi.

Midis institucioneve vendore dhe organizatave në **Bashkinë Roskovec** ekziston një bashkëpunim i mirë, gjë që reflektohet edhe në rritjen e rasteve të denoncimit të dhunës. Gjatë pandemisë Covid -19 është ofruar shërbim online për mbështetje psikologjike kundrejt 5 rasteve, këshillim ligjor për 2 raste, shërbim shëndetësor për 2 raste, si dhe shpërndarje e paketave ushqimore për 9 raste.

- Policia e shtetit: është mbështetëse dhe e ndjeshme ndaj rasteve të dhunës, por sikurse u evidentua nga fokus grupi, problematik qëndron fakti që nuk ka përditësuar ndryshimet e reja të kuadrit ligjor, lidhur me rastet e vlerësimit të riskut dhe kjo çon në vlerësime jo të sakta të rasteve që mund të jenë kritike.
- Shërbimet sociale në nivel bashkie: ofrojnë mbështetje psiko-sociale, transport dhe mbështetje ligjore.
- Shërbimet e ofruara nga organizatat e shoqërisë civile. Aktualisht, me UNDP po realizohet projekti “Forcimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës, në Bashkinë Roskovec”.

Gjatë periudhës së Covid-19, **Bashkia Mallakastër** ka realizuar disa bashkëpunime për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje:

- Në kuadër të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje është bashkërenduar puna me Policinë, Gjqësorin dhe Spitalin. Gjqësori ka dhënë urdhër mbrojtjeje të menjëhershme për 4 raste përmes një procedure të përsheptuar. Nga administrata e Bashkisë nën shoqërimin e policisë, viktimat kanë marrë shërbim mjekësor në spital. Ndërkaq, Policia ka shoqëruar rastet drejt strehëzës së përkohshme dhe vazhdon t’i ketë nën mbrojtje.
- Po ashtu, në bashkëpunim me ZVA Mallakastër, është ofruar shërbim online nga psikologët e ZVA-së për trajtimin psikosocial të familjeve & fëmijëve, në mënyrë individuale dhe në grup.
- Gjatë kësaj periudhe është vënë në dispozicion dhe janë publikuar në median lokale numrat e telefonit të punonjësve socialë, të Policisë së Shtetit, të Kryetarëve të Njësie Administrative për raportimin e dhunës në situatë emergjence. Gjithashtu, janë kyer njoftime për të ndërgjegjësuar dhe të raportuar për dhunën në familje raportime në mediat si Top Channel, Neës 24 në mënyrë që informacioni të përçohet edhe në komunitetet në zonat tona rurale.

Në **Bashkinë Elbasan** komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstitutional është realizuar në komunikim të vazhdueshëm të Drejtorisë së Shërbimit Social pranë Bashkisë me Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Bashkia Elbasan, , gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ka bashkëpunuar edhe me Drejtorinë e Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Komunitare të Bashkisë së Elbasanit, specialistët e policimit në komunitet, Njësinë e Mbrojtjes për të Drejtat e Fëmijëve, organizatat e shoqërisë civile si A2B, “Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë”, “Tjetër Vizion” dhe “Forumi i Gruas” Elbasan.

Në **Bashkinë Dropull** bashkëpunimi ndërinstitutional është vlerësuar si pozitiv:

- Policia e Shtetit ka kryer në kohë vlerësimin e riskut për rastin e raportuar dhe e ka përcjellë pranë gjykatës. E mbijetuara e dhunës në familje është njohur me masat dhe shërbimet që ofron mekanizmi i dhunës dhe më pas UMM.
- Shërbimet Sociale në Bashki kanë ofruar mbështetje ekonomike mujore në vlerën prej 3,000 lekë.
- Përveç sa më sipër, është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha masat specifike të sugjeruara nga ana e tyre për të trajtuar rastet në kushtet e kufizimeve për shkak të COVID-19.

Gjatë fokus grupit për **Bashkinë Gjirokastrë**, bashkëpunimi është vlerësuar pozitiv në veçanti me Policinë, Bashkinë dhe Shërbimin Psikosocial. Bazuar në opinionet e dhëna gjatë fokus grupit, cilësia e ofrimit të shërbimeve është e kënaqshme, por duhet të ketë më shumë ndihmë dhe vëmendje edhe ndaj fëmijëve të kategorisë të viktimave të dhunës, por edhe grupeve në nevojë.

Bashkia Durrës bashkëpunon me agjensitë dhe organizatat lokale për të adresuar dhe për të trajtuar rastet e dhunës:

Zyra e Shërbimit Social, me ndihmën e organizatave lokale, ka ndjekur rastet e dhunës në familje në mënyrë të vashdueshme. Por, kërkohet një bashkëpunim edhe më i ngushtë në lidhje me ndarjen e të dhënave të rasteve të dhunës me bashkinë.

Administrata e **Bashkisë Gramsh** ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera që ndihmojnë në adresimin e dhunës në familje.

- Policia e shtetit, e cila ofron një shërbim të menjëhershëm dhe efikas, si dhe janë të ndjeshëm ndaj rasteve të dhunës, duke qenë në dispozicion në çdo orar.
- Strukturat e shërbimeve Sociale, që janë të pranishme gjatë gjithë procesit të menaxhimit të situatës së dhunës në familje.
- Organizatat japin mbështetje psikologjike dhe ligjore, përfshirë edhe rastet e divorceve, duke u bërë një faktor kyç në luftën ndaj dhunës në familje.

Në **Bashkinë Kamëz** ekziston një bashkëpunim efektiv edhe me institucione dhe aktorë të tjerë të përfshirë në trajtimin e rasteve të dhunës

- Midis institucioneve vendore dhe organizatave ekziston një bashkëpunim aktiv, në shkëmbimin e informacionit dhe adresimit të rasteve nga institucionet vendore dhe

në ofrimin e shërbimit nga organizatat. Gjithashtu, Policia e Shtetit jep një ndihmesë dhe mbështetje të konsiderueshme në çdo rast.

- Në kuadër të funksionimit të MKR-së është nënshkruar një Marrëveshje sërish midis institucioneve kryesore në nivel vendor: Bashkia Kamëz, Qendra Shëndetësore, Qendra Kombëtare e Trajtimin të Viktimave të Dhunës, Zyra e Punës, Zyra Arsimore Vendore dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”, ku të gjitha rastet që kanë ardhur në komisarariat dhe kanë kërkuar urdhër mbrojtje apo kanë pasur precedent të dhunës në familje, janë trajtuar duke identifikuar nevojat dhe më tej janë drejtuar për shërbime tek organizatat partnere. Organizatat kryesore me të cilat Bashkia Kamëz bashkëpunon janë: Ëord Vision, Caritas, Global Care dhe Qendra për Mbrojtjen ndaj Dhunës.
- Policia e shtetit konsiderohet si institucioni më bashkëpunues duke shoqëruar koordinatoren vendore në familjet që përbëjnë rrezikshmëri dhune dhe qëndrojnë në dispozicion në çdo orar.

Në **Bashkinë Lushnje**, Drejtoria e shërbimeve sociale ka bashkëpunuar në çdo rast me drejtoritë brenda Bashkisë për sigurimin e ndihmave ushqimore për familjet ku ushtrohet dhunë si dhe një bashkëpunim të ngushtë kanë pasur me kryepelqetë dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Bashkëpunimi nuk ka munguar as me komunitetet fetare.

Në **Bashkinë Klos** aktorët e fokus grupit e vlerësojnë bashkëpunimin efektiv midis institucioneve vendore, lokale e qendrore dhe konkretisht midis Bashkisë Klos, Drejtorisë së Shëndetit, Drejtorisë Rajonale të Punësimit Dibër dhe Drejtorisë së Policisë.

Bashkia Peqin ka ofruar bashkëpunim me të gjitha institucionet për identifikimin dhe shërbimet e domosdoshme ndaj këtyre familjeve. Aktorët që bashkëpunojnë për adresimin e DHF dhe DHBGJ janë: Prefektura, Gjykata, Zyra e Përmbartimit, Spitali rajonal, Mjeku i familjes, Shërbimi i Emergjencës, Policia, Zyra e Punës, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social. Nga të dhënat e mbledhura nga fokus grupi, bashkëpunimi ndërinstitutional nuk ka qenë në nivele të kënaqshme, pasi sipas tyre ka mungesë të burimeve njerëzore për të ndjekur çështjet e rasteve të dhunës.

Gjatë komunikimit me fokus grupin të zhvilluar në **Bashkinë Pustec** doli në pah ngërçi në bashkëpunimin ndërinstitutional. Midis Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN), ka bashkëpunim formal dhe aspak efektiv. Rasti i dhunës i vetmi i raportuar për vitet 2019-2020 i është referuar Bashkisë vetëm në momentin kur është marrë Urdhëri i Mbrojtjes nga Gjykata, duke kufizuar mundësinë e ndihmës nëse viktimat do të kishte nevojë për strehim emergjence.

Nga instancat vendore ka pasivitet në komunikim dhe indiferencë. Nga ana e Bashkisë është kontaktuar “Kisha e Jezu Krishtit për Ballkanin” për të ngritur një qendër emergjence në Pustec. Por kjo e fundit nuk ka kapacitetin e mjaftueshëm për të mbështetur këtë iniciativë, gjithësesi ofron bashkëpunim për strehimin emergjent në qendrën e tyre në qytetin e Korçës.

Administrata e **Bashkisë Skrapar** ka bashkëpunuar gjatë kësaj periudhe me Policinë, Gjyqsorin, Spitalin, Zyrën Arsimore, Postën si edhe janë vënë në dispozicion linja telefonike. Bashkëpunimi ndërinstutcional ka qenë në nivele të kënaqshme dhe kanë qenë në gatishmëri të plotë për të shërbyer në mënyrë korrekte e të shpejtë në situata të mundshme të dhunës në familje.

Administrata e **Bashkisë Finiq** ka bashkëpunuar gjatë kësaj periudhe me Policinë, Gjyqësorin, dhe spitalin për të dy rastet e dhunës më bazë gjinore. Gjyqësori, ka dhënë urdhër mbrojtjeje të menjëhershme, për 2 viktimat përmes një procedure të shpejtë, pa pagesë dhe pa pasur nevojë për ndihmën e një avokati. Nga administrata e Bashkisë, me shoqërimin e policisë viktimat kanë marrë shërbim mjekësor në spital. Policia e ka shoqëruar një rast drejt një strehëze të përkohshme, dhe ka marrë në mbrojtje të dy rastet. Pjesëmarrësit në fokus grup mendojnë se bashkëveprimi ndërinstutucional nuk është në nivelin e duhur dhe të kërkuar, pasi ka mungesë në burime njerëzore në polici dhe të specializuara në Bashki, duke u shprehur se për rastet e dhunuara kishin dijeni që policia për arsye të mungesës së stafit nuk ka vepruar me shpejtësi.

Për **Bashkinë Divjakë** gjatë periudhës Covid-19 ka rezultuar një bashkëpunim shumë i mirë me të gjitha njësitet administrative për të ndjekur çdo rast të referuar prej specialistëve vendorë me policinë e shtetit në lidhje me raportimin e dhunës dhe me gjykatën për të shpejtuar sigurimin e urdhërave të mbrojtjes.

VII. SUGJERIME PËR KËSHILLAT BASHKIAKË PËR NJË ADRESIM DHE MENAXHIM MË TË MIRË TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Komisionet e Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale në bashkitë respektive kanë mbledhur informacioni nga administrata e Bashkisë dhe takimet e organizuara me fokus grupe mbi nevojat dhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve ndaj dhunës në familje. Në vijim paraqiten sugjerimet përkatëse këshillat bashkiakë për secilën nga bashkitë.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Shkodër.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit:

- **Strehim afatgjatë të viktimave të dhunës në familje** dhe zgjerim të kapaciteteve për strehim emergjent.
- **Përmirësim i bashkëpunimit ndërinstitutional** nëpërmjet marrjes së përgjegjësisë sipas legjislacionit në fuqi nga secili prej anëtarëve të MKR-së.
- **Rritje të burimeve financiare** për të zgjeruar kapacitetet njerëzore, infrastrukturore, të cilat mungojnë në të shumtën e rasteve.
- **Fuqizimi socio-ekonomik dhe riintegrimi** në shoqëri i viktimave/të mbijetuarve të dhunës në marrëdhëniet familjare të çdo forme dhune.

Nga grupet e interesit pjesëmarrës në fokus grup u sugjerua:

- **Realizimi i tryezave dhe takimeve** më të shpeshta të organizuara nga Bashkia Shkodër në lidhje me adresimin më të saktë të nevojave dhe rasteve të dhunës në familje. Njohja me situatën në mënyrë që të mos të ketë mbivendosje shërbimesh.
- **Përgatitja për një sistem statistikor**, i cili përditësohet automatikisht dhe është i bazuar në dokumentimin dhe hartëzimin e rasteve të dhunës.
- **Ndjekja e problematikave të dhunës në gjithë territorin e Bashkisë nga KB**, në ndihmë të zgjidhjes së problematikave dhe adresimin e rasteve për ndihmë pranë administratës së Bashkisë.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Belsh.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjerohet:

- **Alokim të fondeve në buxhet** për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Nga pjesëmarrësit në fokus grup u sugjerua si më poshtë: **Përmirësimi i shërbimeve për adresimin e dhunës nga Bashkia**. Organigrama e Bashkisë duhet të përfshijë më shumë staf për të mbështetur shërbimet sociale. Shërbimi i psikologut(es) që do t'i bashkëngjitet punës së Koordinatorës Vendore duhet të mbulohet nga buxheti i Bashkisë dhe jo nga projekte të veçanta;

- **Rritja e fondeve të emergjencës dhe fondeve të veçanta** në mbështetje të rasteve të dhunës;
- **MKR duhet të shtojë fokusin e punës së vet edhe për monitorimin e dhunës ndaj grave më aftësi të kufizuara** pasi edhe kjo kategori ka mjaft vështirësi dhe mangësi në marrjen e shërbimeve.



Për këshillin bashkiak të Bashkinë Delvinë.

Nga Zyra e Shërbimeve Sociale sugjerohet

- **Shtim në organikë për punonjës socialë dhe psikologë** për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në nivel bashkie po ashtu edhe në njësi administrative;
- **Alokim buxheti të dedikuar** për menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- **Mbështetje financiare për:**
 - 1) organizimin e më shumë aktiviteteve ndërgjegjësuere të fokusuara tek edukimi i grave për të drejtat e tyre;
 - 2) rritjen e kualifikimit të punonjësve socialë për menaxhimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
 - 3) për ngritjen e një qendre emergjence në ndihmë të grave dhe vajzave të dhunuara.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Dropull.

Grupet e interesit në fokus grup sugjerojnë:

- **Mbështetja e MKR-së në Dropull**, përtej mbështetjes së ofruar nga projekti i UNDP-së.
- **Planifikimi dhe aprovimi i një fondi të veçantë në buxhetin e Bashkisë**, për vijueshmërinë e punës së Koordinatorës kundër dhunës në familje dhe mbarëvajtjen administrative operacionale të Zyrës së Dhunës në Bashkinë Dropull.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Gjirokastrë:

Nga aktorët që ishin pjesë e fokus grupit u sugjerua si më poshtë:

- **Të rimerren fushatat ndërgjegjësuere për informimin e popullatës** për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje sapo të ketë lehtësim të masave të ndërmarra për përballimin e pandemisë Covid-19;
- **Të rriten fondet për të mbështetur viktimat/të mbijetuarit e dhunës dhe fëmijët e tyre** sidomos gjatë periudhave të krizave dhe emergjencave të ngjashme me Covid-19.
- **Të rriten kapacitetet e punonjësve të dhunës në familje** për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Kamëz:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjeron si më poshtë:

- **Të krijohet një sektor i veçantë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunën në Familje** brenda Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në Bashki;
- **Shtimi i punonjësve të PMF/Koordinator** në nivel Njësie Administrative;
- **Alokim buxheti vjetor për menaxhimin e rasteve** nga Bashkia;
- **Pajisja me automjet** për të realizuar vizitat në familje;
- **Ngritja e shërbimeve mbështetëse** me qendra ditore, qendra rezidenciale, etj.
- **Vëmendje e shtuar për strukturën bashkiake për ndihmën sociale**, e cila ka nevojë të theksuara për buxhet, staf dhe një plan social të mirëstrukturuar.

Ndërsa nga aktorët që ishin pjesë e fokus grupit u sugjerua si më poshtë:

- **Rritja e kapacitetit të burimeve njerëzore** për menaxhimin e situatës së dhunës në familje dhe mbulimin e të gjithë territorit të Bashkisë;
- **Përfshirja e një psikologu(eje)** në staf.
- **Krijimi i një buxheti të dedikuar** për mbrojtjen sociale dhe të dhunës në familje.
- **Krijimi i kushteve për transport** për Koordinatorin e Dhunës në Bashki.
- **Aplikimi i një plani social 5 vjeçar** për t'u zbatuar në qytetin e Kamzës.
- **Krijimi i një qendre multifunkionale apo qendre ditore që ofron shërbim psiko-social me punonjës social dhe psikologët** përkatës për të gjitha kategoritë: fëmijë, gra, të rinj dhe të moshuar dhe për këdo që ka nevojë për ndihmë.
- **Krijimi i një qendre Strehimi Emergjence** për rastet me rrezikshmëri dhe prioritet të lartë.
- **Përfshirja në programet mësimore** i një cikli leksionesh për ndërgjegjësimin ndaj dhunës.
- **Rritja e numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë** në shkolla.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Klos:

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjerohet:

- **Alokim buxheti** për menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Sugjerime nga aktorët që ishin të pranishëm në fokus grup: **Zhvillimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve**, duke u shtrirë edhe në zonat rurale, në lidhje me të drejtat e tyre dhe shërbimet që ofrohen në territor për viktimat e dhunës në familje nga Bashkia apo institucione të tjera.

- **Miratimi i një fondi të dedikuar** vetëm për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.
- **Ngritja e një qendre multifunkionale**, e cila të ofrojë shërbime psikologjike, juridike dhe kurse për aftësim profesional.

- **Ndjekje e problematikave të dhunës në gjithë territorin e Bashkisë** nga KB në ndihmë të zgjidhjes së problematikave, informimin, por edhe adresimin e rasteve për ndihmë pranë administratës së Bashkisë.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Korçë:

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjerohet si më poshtë:

- **Krijimi i një fondi emergjent** për gratë e dhunuara. Duke qenë se gratë kanë nevoja emergjente, duhet të krijohet një fond për të mbuluar nevojat urgjente sidomos të 72 orëve të para, sic është transporti, ushqimi, veshmbathje apo nevoja të ngjashme.
- **Zhvillimi i trajnimeve me anëtarët e MKR-së.** Nevojiten trajnime të përbashkëta, ku të marrin pjesë të gjithë anëtarët e mekanizmit në mënyrë që zbatueshmëria e ligjit të jetë sa më efektive dhe informacioni të jetë i plotë edhe për ata anëtarë që janë zëvendësuar ndër vite brenda mekanizmit të referimit. Ndryshimi i herë pas hershëm i përfaqësuesve të institucioneve publike pjesë e MKR-së, sjell një pengesë në menaxhimin e rasteve ashtu siç duhet, sepse përfaqësuesit e rinj nuk njihen me procesin dhe detyrat konkrete ligjore.
- **Bashkëpunimi me Qendrën e Formimit Profesional.** Bashkia Korçë të bashkëpunojë me Qendrën e Formimit Profesional, për t'i ofruar grave të dhunuara mundësinë për kurse profesionale.
- **Vetpunësimi për viktimat e dhunës.** Të shqyrtohet mundësia e vetëpunësimit për gratë e dhunuara. Të krijohet një fond për mbështetjen e grave që mund të hapin një biznes privat për fuqizimin e tyre ekonomik. Krijimin e kushteve lehtësuese për taksat vendore për një periudhë kohe të caktuar, e cila do të shërbejë për fuqizimin e tyre në biznes.

Grupet e interesit që marrin pjesë në fokus grup sugjerojnë:

- **Rritje e ndërgjegjësimit për parandalimin e dhunës.** Parandalimi është shumë i rëndësishëm për të ulur rastet e dhunës, ndaj fokus më i madh i duhet dhënë parandalimit përmes veprimatrive ndërgjegjëse.
- **Monitorimi për rastet e dhunës edhe pas periudhës Covid-19,** po ashtu edhe rastet e divorceve që mund të regjistrohen në periudhën në vijim.
- **Publikimi i të dhënave personale për rastet e dhunës** duhet të kufizohet. Raportimi rreth rasteve të dhunës duhet të përqëndrohet në mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarve, mbrojtjen e të dhënave dhe vërtetësinë e fakteve.
- **Marrja e masave në bazë të kuadrit ligjor për mediat të cilat nuk respektojnë mbrojtjen e viktimave të dhunës.** Media duhet trajnuar vazhdimisht për raportime të ndjeshme mbi rastet e dhunës.
- **Ngritja e një rrjeti për çështjet e barazisë gjinore** ku të ketë edhe përfaqësues të medias që të kuptojnë dhe njohin çështjet e dhunës.
- **Zhvillimi i programeve për rehabilitimin e dhunuesve** në mënyrë që jo vetëm të parandalohet apo ndalohet dhuna, por edhe të mundësohet riintegrimi i personave për të ndërprerë ciklin e dhunës.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Kurbin.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale

- **Ngritja e një qendre emergjente apo rezidenciale.** Bashkia Kurbin nuk ka qendra emergjente apo rezidenciale për menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhënie familjare;
- **Alokimi i një fondi në dispozicion për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.**

Sugjerime nga aktorët pjesëmarrës fokus grup:

- **Të përditësohet faqja e Bashkisë Kurbin** në lidhje me shërbimet që ofrohen dhe personat përgjegjës.
- **Të realizohet monitorim i vazhdueshmë i administratës së Bashkisë nga Këshilli Bashkiak** për ndjekjen e problematikave dhe çështjeve sociale në territorin e Bashkisë.
- **Të zhvillohen veprimtari ndërgjegjësuere për dhunën në familje** me të rinjtë dhe kryesisht në shkolla.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Malësi e Madhe

Sugjerime nga Sektori i Shërbimeve Sociale sugjerohet:

- **Alokim buxheti për menaxhimin e rasteve të dhunës.** Duke marrë parasysh nevojën aktuale të rasteve të dhunës për t'u menaxhuar nga sektori i shërbimeve sociale, kërkohet nga ana e Këshillit Bashkiak që të alokojë buxhetin për menaxhimin e rasteve të dhunës.

Ndërsa grupet e interesit që morrën pjesë në fokus grup sugjeruan si më poshtë:

- **Rritje e ndërgjegjësimit dhe informimit të institucioneve edhe i komunitetit** për referimin e rasteve të mundshme të dhunës.
- **Krijimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës** brenda territorit të Bashkisë Malësi e Madhe.
- **Krijim i fondeve rezerve** për raste emergjente të dhunës në familje.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Maliq.

Nga grupet e interesit që ishin pjesë e fokus grupit u sugjerua si më poshtë:

- **Të ndërmeren fushata sensibilizuese për të informuar publikun** për adresimin dhe ndihmën ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Të alokohet çdo vit një buxhet i dedikuar** për t'u përdorur në ndihmë të viktimave të dhunës;

- **Të hartohet buxheti gjinor në çdo investim në territorin e Bashkisë** duke patur fillimisht konsultim me grupet e interesit;
- **Të vihet në dispozicion një numër telefoni nga Bashkia** për të adresuar rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Të punohet me median lokale për informim të publikut** për të raportuar dhunën në familje si dhe për ndihmën dhe shërbimet që ofrohen për rastet e dhunës në familje.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Memaliaj.

Sugjerime nga administrata e Bashkisë:

- **Shtesë në strukturën organike** për dy punonjës socialë dhe psikologë;
- **Alokim buxheti** të dedikuar për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Mbështetje për ngritjen e një strehëze** për raste emergjente të dhunës, si edhe të një qendre multisociale;
- **Mbështetje financiare** për organizimin e më shumë aktiviteteve ndërgjegjëse të fokusuara tek edukimi i grave për të drejtat e tyre.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Mirditë.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Ristrukturim i organikës në sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashki.** Ndarja si drejtori më vete dhe funksionimi me dy sektorë brenda kësaj drejtorie, shtimi me 2 (dy) punonjës sociale, 1 (një) për Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe 1 (një) për Menaxhimin e rasteve.
- **Hartimi i projekt-buxhetit për alokim fondesh sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashki,** pasi është domosdoshmëri për identifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës në familje.
- **Alokim buxheti për lëvizjet drejt Njësive Administrative.** Bashkia ka një territor shumë të madh dhe distanca nga qendra ku ndodhen shërbimet është shumë e madhe drejt Njësive Administrative.

Nga aktorët pjesëmarrës në fokus grup u sugjerua si mëposhtë:

- **Nisma për njohjen e strukturës së shërbimit social në nivel vendor** dhe promovimi në komunitet për shërbimet që ofrohen.
- **Planifikim i shërbimeve me protokoll të veçantë** për rastet e dhunës në familje.
- **Zhvillimi i aktiviteteve për ndërgjegjësim dhe informin** për të parandaluar dhe raportuar rastet e dhunës në familje.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Peqin.

Drejtorja e Shërbimeve Sociale sugjeron si më poshtë:

- **Alokim në buxhetin e Bashkisë për krijimin e një qendre emergjence funksionale** për rastet e dhunës për të ofruar strehim dhe këshillim psikologjik;
- **Punësimi i një punonjesi(eje) në çdo njësi administrative** për rastet e dhunës në familje.

Nga aktorët pjesëmarrës në fokus grup u sugjerua si mëposhtë:

- **Të ndërmerren fushata ndërgjegjëse** për të informuar publikun për raportimin e dhunës në familje;
- **Të financohet krijimi i një qendre multifunksionale** për të trajtuar rastet e dhunës në familje;
- **Të ndërmerren fushata ndërgjegjëse** dhe në shkolla duke i bërë pjesë të programeve mësimore.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Pustec:

Drejtorja e shërbimeve sociale sugjeron:

- **Krijimin i një buxheti specifik për menaxhimin e rasteve të dhunës.**
- **Punësimin i një psikologu(je) të specializuar** dhe të trajnuar për rastet e dhunës në familje.

Sugjerime nga fokus grupi për Këshillin Bashkiak: **Krijimin e bashkëpunimeve me organizata të shoqërisë civile** që trajtojnë rastet e dhunës, një ndër të cilat ndodhet në Korçë dhe ofron strehëzë emergjence për 72 orë;

- **Mbështetjen e viktimave të dhunës me banesa sociale ose bonuse qeraje.**
- **Krijimin e programeve të ndërgjegjësimi** dhe shpeshimin e kontakteve me institucionet arsimore.
- **Zgjerimin e mundësive të punësimit** përmes bashkëpunimeve me bizneset lokale dhe hartimin e politikave lehtësuese.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Roskovec:

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale për Këshillin Bashkiak:

- **Krijimin e një qendre për dhënie të shërbimeve psiko-sociale;**
- **Hartimin dhe miratimin e nismave me ndjeshmëri gjinore.**

Ndërsa nga grupet e interesit në fokus grup u sugjerua:

- **Krijimi i një buxheti të veçantë** për menaxhimin e dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore;

- **Krijimi i një pakete më të plotë ekonomike** për mbështetjen e grave dhe vajzave të mbijetuara të dhunës në familje që nuk kanë burime të mjaftueshme të ardhurash;
- **Krijimi i banesave sociale ose pagesa të qerave** për viktimat/të mbijetuarit e dhunës;
- **Rritja e numrit të psikologëve në shkolla**, pasi shumë problematika identifikohen edhe në institucionet arsimore.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Poliçan.

Sektori i shërbimeve sociale sugjeron si më poshtë:

- **Punësimin e një psikologu (eje)** në stafin e Bashkisë për të menaxhuar rastet e dhunës.
- **Ngritjen e kapaciteteve të stafit** me trajnime e specializime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Sugjerime nga pjesëmarrësit në fokus grup:

- **Miratimin e një buxheti të veçantë për** menaxhimin e situatave të dhunës;
- **Realizimin e aktiviteteve informuese** dhe programeve ndërgjegjësuere për dhunën në institucionet arsimore.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Shijak:

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimet Sociale:

- **Strehimi në rastet emergjente:** krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për gratë e dhunuara dhe fëmijët e tyre ku mund të qëndrojnë për të paktën 72 orë për të mundësuar strehimin emergjent.

Sugjerime nga aktorët pjesëmarrës në fokus grup:

- **Strehimi në rastet emergjente:** Mbështetje për ngritjen e një qendre për strehimin e emergjencës.
- **Banesa sociale:** Shfrytëzimin e kapaciteteve/aseteve ose krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për ndërtimin e banesave sociale.
- **Mbështetje financiare:** për organizimin e aktiviteteve me karakter ndërgjegjësuere dhe për programe për trajnimin dhe kualifikimin e stafit.
- **Burime njerëzore:** Rritje të burimeve njerëzore të sektorit social.
- **Aktivitete ndërgjegjësuere në shkolla:** Realizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere, informuese dhe rritjen e prezencave nëpër shkolla.
- **Bashkëpunim me organizatat jo-fitimprurëse:** Krijimin e mundësive për bashkëpunime me OJF-të lokale.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Skrapar.

Nga aktorët që ishin pjesë e fokus grupit u sugjerua si më poshtë:

- **Të mbështetet projekti plan-social i Bashkisë** për funksionimin e një qendre multifunkionale për moshën e tretë dhe për rastet e mbështetjes së rasteve të dhunës që do të paraqiten.
- **Të alokohet një fond i posaçëm** për të menaxhuar rastet e dhunës në familje;
- **Të ndërmerren fushata sensibilizuese** për të informuar publikun për adresimin dhe ndihmën ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- **Të ndërmerren fushata mediatike**, pasi media lokale luan rol informues dhe edukues dhe ndiqet nga publiku.
- **Të bashkëpunohet dhe të koordinohet** me të gjitha institucionet për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Libohovë.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Rritja e buxhetit për ndihmën ekonomike nga Bashkia** ku të përfshihen dhe personat e dhunuar pasi u përfundon afati i Urdhrave të Mbrojtjes.

Sugjerime nga zhvillimi i fokus grupit për Këshillin Bashkiak:

- **Të kontaktohet media lokale në mënyrë që publiku të ndërgjegjësohet** për luftën kundër dhunës në familje.
- **Krijimi i një Departamenti për Aplikimin e Projekteve**, duke u përpjekur në këtë mënyrë të sigurojë mbështetje nga donatorë të huaj lidhur me çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- **Të hapet një zyrë ose qendër për shërbime psikologjike**, ku psikologjia të jetë nga një qytet tjetër pasi pengesë e madhe për adresimin e dhunës mbetet mentaliteti dhe paragjykimi.
- **Të aplikohet plani social**, i cili ka mbetur ende në draft.
- **Të sigurohet ndihmë ekonomike ose një strategji punësimi** për dhënien e pavarësisë së grave të dhunuara, vetëm në këtë mënyrë ato mund të largohen nga situata e dhunës.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Vlorë.

Sugjerime nga KBGJ dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale për një adresim më të mirë të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- **Avancimi në zbatimin** për ngritjen e Qendrës së Emergjencës **të parashikuar në Planin Social** - Planin Social i Bashkisë Vlorë është hartuar dhe është miratuar në parim nga KB, por duhet mbështetur edhe financiarisht nga Bashkia ose Ministria e linjës, sidomos zbatimi i një prej pikave të Planit Social të miratuar nga KB Vlorë në muajin Nëntor 2018, për ngritjen e Qendrës së Emergjencës për të gjitha kategoritë në nevojë.
- **Zgjerimi i kapaciteteve në Drejtorinë e Shërbimit Social** - shtimi i numrit të specialistëve për Njësinë e Mbrojtjes së Femijës si dhe të një specialist (eje) shtesë në zyrën e Koordinatorit të Dhunës në Familje.

Nga grupet e interesit pjesëmarrës në fokus grup sugjerohet:

- **Rritja e buxhetit për shërbimin social në Bashkinë e Vlorës** për të mbështetur e viktimat të dhunës me strehim.
- **Buxhetimi si zë më vete në buxhetin e drejtorisë së shërbimit social për transportin e viktimave/mbijetuarve të dhunës në familje dhe fëmijëve** drejt institucioneve kombëtare në qytetet e tjera.
- **Zhvillimi i takimeve dhe dëgjësive publike** me gra dhe vajza në territorin e Bashkisë për të identifikuar nevojat dhe problematikat e jetesës së tyre.
- **Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të KBGj-së** dhe zhvillimi i takimeve të ndryshme me aktorë të tjerë për menaxhimin e dhunës.
- **Punësimi i një coordinator(e) shoqëror(e)** në dispozicion në ditët e fundjavës, ose të konsiderohet mundësia për të shpërblyer orët e punës jashtë orarit zyrtar të koordinatorëve aktualë.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Kukës.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjerohet:

- **Lobim nga ana e Këshillit Bashkiak** nëpërmjet komisionit të barazisë gjinore në bërjen prezente të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje tek të gjithë anëtarët e KB-së;
- **Hartim i programeve për punësim dhe strehim** për të adresuar nevojat e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- **Alokim i fondit social për ngritjen e një qendre pritëse emergjence** deri në 48 orë për viktimat e dhunës për të marrë masën e sigurisë së jetës;
- **Shtimin e stafit profesionist që ofron shërbim për viktimat e dhunës;**
- **Alokim çdo vit i një buxheti të dedikuar** për rastet e dhunës në familje;
- **Buxhetim gjinor** duke përcaktuar numrin e përfituesve sipas gjinisë për çdo investim në territorin e Bashkisë, si dhe të ketë konsultim të tij me grupet e interesit.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Divjakë.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjerohet:

- **Shtim i numrit të punonjësve socialë apo psikologëve në njësitë administrative** për një kujdes të shtuar ndaj viktimave/të mbijetuarve të dhunës apo familjeve me probleme të ndryshme;
- **Parashikime shtesë në buxhet për drejtorinë e shërbimeve sociale** pasi shërbimet janë në terren të hapur dhe në largësi.

Nga aktorët që ishin pjesë e fokus grupit sugjerohet:

- **Bashkëpunim më i ngushtë me administratën e drejtorisë së shërbimeve** për rritjen e performancës së shërbimeve ndaj dhunës;
- **Alokim në buxhet për menaxhimin e rasteve të dhunës** në terren.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Mallakastër.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale për Këshillin Bashkiak sugjerohet:

- **Ristrukturim në organikë për punonjës socialë & psikologë** për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie dhe në 9 njësitë administrative;
- **Rritja e kualifikimit për punonjësit socialë aktualë** për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore;
- **Mbështetje financiare për aplikimin e planit social** të Bashkisë Mallakastër;
- **Alokim buxheti të dedikuar** për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Nga grupet e interesit pjesëmarrës në fokus grup sugjerohet:

- **Hartimi i politikave specifike dhe buxhetimi i këtyre politikave** për subvencionimin e biznesit të menaxhuar nga gratë.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Këlcyrë.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimet Sociale:

- **Zhvillimi i programeve ndihmëse** për rastet e dhunës në familje, si: **ngritja e strehëzës emergjente dhe dhënia e bonusit të qerasë**;
- **Ristrukturim organike për dy punonjës socialë dhe psikologë** për trajtimin e rasteve të dhunës në nivel bashkie si edhe në njësitë administrative;
- **Alokim buxheti të dedikuar për menaxhimin e rasteve të dhunës**;
- **Bashkëpunimi në mënyrë të vazhdueshme midis KB dhe Shërbimit Social** në Bashki;
- **Mbështetje financiare për organizimin e më shumë aktiviteteteve ndërgjegjësuere** të fokusuara tek edukimi i grave për të drejtat e tyre;
- **Rritja e kualifikimit të punonjësve socialë** për të kuptuar më mirë dhe reaguar ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Kolonjë.

Sugjerime grupet e interesit pjesëmarrës në fokus grup: **Rritja e stafit të burimeve njerëzore** duke përfshirë këtu një psikolog(e) për të trajtuar rastet të dhunës në familje;

- **Krijimi i programeve dhe politikave integruere** dhe hapjen e mundësive të punësimit veçanërisht për gratë viktime të dhunës;
- **Zbatimi i planit social** të miratuar tashmë;
- **Krijimi i mundësive për trajnime të stafit të qendrës multifunkionale**, për të mbështetur maksimalisht rastet dhunës në familje;

- **Krijimi i programeve ndërgjegjëse** për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Praktimin e platformave online për ndihmën psikologjike**;
- **Vendosjen e një linje të gjelbër për denoncimin lokal të dhunës në familje**;
- **Alokimi në buxhet për menaxhimin e rasteve të dhunës.**



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Elbasan.

Sugjerime Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel të Këshillit Bashkiak është ngritur me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 138 datë 21.12. 2017, në kuadër të hartimit të Planit të Veprimi për Barazinë Gjinore, si dhe në përputhje me masat që duhet të ndërmerren për zbatimin me efektivitet të Kartës Evropiane për Barazi. Ky komision ka rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, në nivel të objektivave. Në këtë kuadër, rekomandojmë:

- **Rritjen e kapaciteteve të Komisionit të Barazisë Gjinore** për realizimin e monitorimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore dhe vendimeve të tjera të Këshillit Bashkiak.

Sugjerime nga zhvillimi i fokus grupit lidhen me:

- **Shtimin e numrit të punonjësve në njësitë administrative** për menaxhimin e rasteve të dhunës në zonat më të largëta.
- **Parashikimin e një fondi shtesë në buxhet** në ndihmë të shtresave në nevojë, kryesisht për gra e vajza të dhunuara.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Finiq.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale :

- **Alokim për buxhet të dedikuar** për shërbime dhe programe mbështetëse për rastet e dhunës në familje.
- **Ristrukturime organike për dy punonjës socialë dhe psikologë** për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në nivel bashkie dhe në njësi administrative.
- **Mbështetje për ngritjen e një qendre multisociale dhe profesionale** për gratë dhe vajzat e dhunuara e të papuna.
- **Mbështetje financiare për organizimin e më shumë aktiviteteve ndërgjegjëse** për të parandaluar dhe raportuar dhunën.

Grupet e interesit që marrën pjesë në fokus grup sugjerojnë:

- **Të krijohen programe e projekte punësimi**, veçanërisht për gratë për të parandaluar dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Gramsh.

Sugjerime Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Krijimi i një qendre multifunkionale** me një staf të specializuar që t'iu ofrojë mbështetje psikologjike, ligjore, sociale grave të dhunuara;
- **Krijimin e një Qendre Emergjence** pasi në shumicën e rasteve viktimat hezitojnë të deklarojnë dhunën, duke qënë se nuk kanë ku të strehohen;
- **Alokimi i një buxheti specifik** për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Sugjerime për Këshillin Bashkiak nga fokus grupi lidhen me:

- **Të alokohet një buxhet më i lartë** për mbështetjen ndaj grave të dhunuara.
- **Ndihmë ekonomike/Banesa Sociale:** Bashkia mund të realizojë marrëveshje me ndërtuesit e pallateve, që një hapësirë të rezervohet për banesa sociale.
- **Zgjerimi i mundësive të punësimit:** marrëveshje për lehtësim taksash ndaj një biznesi që punëson gra të dhunuara e në nevojë.
- **Realizimi i aktiviteteve me karaktere ndërgjegjësuere**, duke bashkëpunuar me mediat lokale dhe duke përdorur rrjetet sociale.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Patos.

Grupet e interesit që morrën pjesë në fokus grup sugjerojnë:

- **Të miratohet një fond i veçantë** për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Të bëhen funksionale strehëzat e emergjencës ekzistuese** të cilave u mungon mobilimi dhe një staf i dedikuar;
- **Ngritja e një qendre multifunkionale gjithëpërfshirëse;**
- **Staf i veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në njësitë administrative.**



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Has.

Sugjerime nga grupet e interesit që morrën pjesë në focus grup:

- **Mbështetje finaciare për organizimin e aktiviteteve informuese** për dhunën në familje;
- **Rritja e kualifikimit të punonjësve socialë** për të kuptuar më mirë dhe reaguar ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Shtimi i stafit profesional, punonjës socialë dhe psikologë**, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në nivel Bashkie dhe në njësi administrative.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Tropojë.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale :

- **Krijimi i nje qendre ditore** për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Të krijohet një fond i posaçëm në buxhet** për menaxhimin e rasteve të dhunës;
- **Alokimin e fondit social për ngritjen e një qendre pritëse emergjence deri 48 orë** për viktimat e dhunës për të marrë masën e sigurisë së jetës;
- **Ngritjen e shërbimeve të reja dhe shtimin e stafit profesionist** që ofron shërbim për viktimat e dhunës.

Grupet e interesit që morrën pjesë në fokus grup sugjerojnë:

- **Monitorimi i vazhdueshëm** nga Këshilli Bashkiak dhe Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale të aktivitetit të administratës së Bashkisë për arritjen e treguesve të barazisë gjinore;
- **Fuqizimin i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit**, u cilësua si nevojë shumë e madhe në këtë Bashki në lidhje me njohjen dhe interpretimin e bazës ligjore.
- **Shtimin e stafit të posaçëm për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.**
- **Rritjen e kapaciteteve të psikologëve të shkollave, të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor** nëpërmjet sesioneve informuese dhe trajnimeve specifike për menaxhimin e rasteve të dhunës.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Bulqizë.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Bonus qeraje për viktimat e dhunës në familje** që nuk kanë mundësi të paguajnë qeranë e një banese dhe nuk kanë të afërm që mund ti përkrahin;
- **Ndihmë financiare** të paktën për një periudhë tremujore derisa të merren masat e duhura për t'i ardhur në ndihmë një rasti të dhunës;
- **Shtimi i pozicionit të 1 psikologu/eje me kohë të plotë pranë Drejtorisë së Shërbimit Social.** Aktualisht pozicioni i psikologes është me kohë të pjeshme dhe është në kuadër të projektit me UNDP-në në bashkëpunim me Bashkinë Bulqizë.

Ndërsa, nga aktorë të fokus-grupit u sugjerua:

- **Ndërtimi ose vihet në funksionim një qendër rezidenciale** për gratë e dhunuara dhe trajtimin e tyre psikologjik e mjekësor;
- **Krijimi i një strukture të specializuar pranë Komisarariatit të policisë** për rastet e dhunës në familje;
- **Trajnime të vazhdueshme** të stafit që merret me rastet e dhunës në familje.
- **Krijimi i hapësirave për punësim sezonal dhe aftësim profesional** për viktimat e dhunës në familje;

- **Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave** për të parandaluar dhunën dhe për të ndihmuar viktimat e dhunës.
- **Pagesa e qerave të shtëpive** për gratë që largohen nga shtëpia dhe që kanë urdhër mbrotje.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Përmet.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Mbështetje financiare për të institucionalizuar shërbime të specializuara mbështetëse** për viktimat/të mbijetuarit e dhunës dhe për dhunuesit;
- **Programe lehtësuese për bizneset artizanale të grave dhe vajzave** për të punësuar gratë dhe vajzat që janë viktimat e dhunës në familje;
- **Mbështetje financiare për ngritjen e një qendre ditore multisociale** për gratë dhe vajzat e dhunuara e të papuna dhe target grupet e marginalizuara.

Grupet e interesit që marrin pjesë në fokus grup sugjerojnë:

- **Ngritja e kapaciteteve profesionale** me qëllim përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe vënien në efikasitet të sistemit të informacionit për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje;
- **Mbështetja me projekte punësimi dhe kualifikimi** veçanërisht për gratë dhe vajzat, si edhe të rinjtë;
- **Ngritja e një qendre rehabilitimi dhe riintegrimi** jo vetëm për viktimat e dhunës, por edhe për dhunuesit;
- **Mbështetje financiare për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere** të fokusuara tek edukimi i komunitetit për çështjet gjinore dhe raportimin e dhunës në familje;
- **Rritja e kapaciteteve kualifikuese të punonjësve socialë** për të kuptuar më mirë dhe reaguar ndaj dhunës me bazë gjinore;
- **Alokim buxheti të dedikuar për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje;**
- **Shtim i stafit profesional, si punonjës socialë dhe psikologë** për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie dhe njësi administrative.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Mat.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Ndërtimi ose vendosja në funksion një qendër rezidenciale** për gratë e dhunuara dhe trajtimi psikologjik e mjekësor i tyre;
- **Krijimi i një strukture të specializuar** pranë Komisarariatit të Policisë me psikologë, juristë dhe mjekë;
- **Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme të stafit** që merret me rastet e dhunës në familje;

- **Krijimi i hapësirave për punësim sezonal dhe aftësim profesional** për gratë dhe viktimat e dhunës në familje;
- **Kryerja e trajtimeve të specializuara për dhunuesit** për ta ndaluar ciklin e dhunës.



Për Këshillin Bashkiak Cërrik.

Disa nga rekomandimet kryesore janë si në vijim:

- **Alokimi i një buxheti të veçantë për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje** (duke përfshirë të gjitha shpenzimet e nevojshme, veçanërisht ato emergjente të cilat duhet të ndërmerren rast pas rasti)
- **Riorganizimi dhe fuqizimi i sektorit të shërbimeve sociale** për rritjen e cilësisë të shërbimeve në kuadër të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
 - a) Transformimi i sektorit të shërbimeve sociale në drejtori dhe shtesë e personelit përkatës.
 - b) Personel i shtuar në njësitë administrative për çdo pozicion të miratuar.
- **Rritja e efektivitetit të qasjes shumë sektoriale dhe shërbimeve bazë të specializuara** për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nëpërmjet:
 - a) Formalizimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Dhunës (Marrëveshje e Bashkëpunimit mes aktorëve dhe ngritja dhe funksionimi i Komitetit Drejtues dhe Ekipit Teknik Ndërdisciplinar)
 - b) Emërimit të një Koordinator/je Vendor/e kundër dhunës në familje si pozicion pune i veçantë dhe me kohë të plotë.
 - c) Organizimi i mbledhjeve të rregullta të ETN dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të tij.
- **Hartimi i politikave për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore**, nëpërmjet fushatave të informimit dhe të ndërgjegjësimit, veçanërisht në shkolla.
- **Krijimi i hapësirave të sigurta publike për të gjitha grupet shoqërore**, duke vlerësuar nevojat për siguri dhe mbrojtje të grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në zonat ku ato planifikohen, ndriçimi i rrugëve, transformimi i shkollave në qendra komunitare, vendosja e kamerave të sigurisë në shkolla e kopshte, garantimi i rojeve të shkollave, etj.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Rrogozhinë.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale sugjerohet:

- **Ngritjen e qendrës për strehimin e emergjencës 72 orëshe** për strehimin e:
 - a) E viktimave të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre të pajisur me Urdhërin e Menjëhershëm të Mbrojtjes.
 - b) E viktimave të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre të pajisur me Urdhërin e Mbrojtjes.
 - c) Fëmijëve pa kujdes prindëror ose të dhunuar, të shfrytëzuar, të abuzuar në situatë rruge dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

d) Të moshuarve të braktisur në situatë rruge.

- **Planifikimi e një buxheti vjetor për menaxhimin e dhunës në familje;**
- **Vendosja në dispozicion e një mjeti transporti** në shërbim të masave ndaj dhunës në familje.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Fier.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Buxhet për shërbimet e transportit** për rastet e dhunës në familje.
- **Shtimi i burimeve njerëzore për koordinatorë vendorë në bashkinë Fier dhe në njësitë administrative.** Pavarësisht ndihmës që jepet nga administratorët socialë, është e nevojshme të ketë punonjës që kanë në fokus të punës për dhunën në familje në çdo njësi administrative.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Librazhd.

Grupet e interesit që marrin pjesë në fokus grup sugjerojnë si më poshtë:

- **Hartimin e politikave për punësimin e grave dhe vajzave** që janë viktimë/ të mbijetuara të dhunës në familje, si për shembull: lehtësimi i taksave dhe vendore për bizneset që punësojnë gratë dhe vajzat që janë viktimë/të mbijetuara të dhunës në familje apo punësim sezonal dhe aftësim profesional;
- **Ndërtimin e një qendre rezidenciale** për gratë e dhunuara dhe trajtimi psikologjik e mjekësor i tyre;
- **Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme** për stafin e shërbimeve sociale që merret me rastet e dhunës në familje.



Për Këshillin Bashkia në Bashkinë Selenicë.

Sugjerimet e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Selenicë janë si më poshtë:

- **Shtim të buxhetit për shërbimet sociale dhe shtim të burimeve njerëzore të specializuara** (punonjës socialë dhe psikologë) për asistimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës.

Grupet e interesit që marrin pjesë në fokus grup sugjerojnë si më poshtë:

- **Zhvillimi i takimeve dhe dëgjësive publike** ku të ketë pjesëmarrës nga i gjithë komuniteti, me qëllim informimin edhe të moshës së tretë për adresimin dhe referimin e rasteve të dhunës, të cilët nuk kanë akses në forma të tjera ndërgjegjësimi dhe informimi.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Delvinë

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe nga aktorët e fokus grupit:

- **Publikimi në faqen e Bashkisë i informacionit për të raportuar dhunën**, numri telefonik për këshillim për rastet e dhunës dhe baza ligjore;
- **Organizimi i fushatave ndërgjegjëse dhe informuese rreth parandalimit të dhunës me bazë gjinore** dhe njohjes së mekanizmave mbrojtës që mund të arrihen dhe të përdoren nga viktimat, duke ruajtur sigurinë e tyre. Fushatat mund të realizohen nëpërmjet posterave, fletëpalosjeve, takimeve në tryeza të ndryshme me komunitetin e gjerë, median, zyrat e punësimit dhe me ekspertët dhe organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut;
- **Mbështetja financiare e masës së qerasë së banesës** në rastet kur ka vendim gjykate dhe i/e demtuara, nuk mund të qëndrojë në të njëjtën banesë me dhunuesin (en).



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Kuçovë.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- **Buxhetim gjinor** duke përcaktuar numrin e përfituesve meshkuj, femra për çdo investim në territorin e Bashkisë si dhe të ketë konsultim të tij me grupet e interesit;
- **Mbështetja e projekti të planit social të bashkisë** për funksionimin e një qendre multifunkionale për strehimin dhe mbështetjen e rasteve të dhunës.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Lushnje

Sugjerime nga aktorët e fokus grupit për Këshillin Bashkiak:

- **Vëmendje e shtuar në lidhje me parashikimet në buxhet** për rritjen e aksesit përmes shërbimeve sociale në njësitë administrative.
- **Parashikim i investimeve në qendra komunitare** ku merren shërbime të specializuara për target grupe në nevojë.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Krujë

Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Krujë, grupet e interesit që morrën pjesë në fokus grup sugjerojnë:

- **Përmirësim i shërbimit për këshillimi falas** duke ndarë informacionin me të gjithë njësitë administrative.
- **Parashikimi në buxhet për zyrën e shërbimeve sociale** për të zgjidhur çështje të logjistikës.
- **Vënia në funksion e qendrës multidisciplinare.**
- **Vëmendje e shtuar për rritje të stafit në shërbimet sociale.**



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Pogradec.

Sugjerime nga Drejtoria e Shërbimeve:

- **Buxheti gjinor në programet e Bashkisë;**
- **Buxhetim për punësimin e një punonjësi(je) social(e) në qendrën ditore;**
- **Buxhetim për punësimin e punonjësve sociale në Njësitë Administrative** me qëllim adresimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Ngritja e kapaciteteve të administratës së Bashkisë** në shërbim të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
- **Promovimi i produkteve artizanale të grave** në përgjithësi dhe të grave të dhunuara në veçanti.

Sugjerime nga pjesëmarrësit në fokus grup:

- **Të krijohet bashkëpunim me Zyrën e Punësimit** me qëllim angazhimin e grave në programet e formimit profesional dhe të punësimit të tyre me anë të programit të nxitjes së punësimit, me qëllim final fuqizimin ekonomik të tyre duke ngritur kapacitetet profesionale të tyre dhe ingranimin në jetën sociale.
- **Të zhvillohen fushata informuese rreth parandalimit të dhunës me bazë gjinore**, si dhe njohjes së mekanizmave mbrojtës që mund të përdoren nga viktimat me qëllim që të ruhet siguria e tyre.
- **Të bashkëpunohet me aktorë lokalë apo donatorë të ndryshëm për krijimin e një qendre këshillimi** për trajtimin e personave dhunues me probleme të konsumimit të alkoolit, me problematika devijante apo apo me shqetësime emocionale.



Për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Durrës.

Nga ana e shërbimeve sociale në Bashki sugjerohet:

- **Të krijohen plane emergjence** për personat me probleme të shëndetit mendor.
- **Të sigurohet një buxhet për dhënien e shërbimeve plotësuese** për familjen në tërësi, përfshirë këtu: mbështetje psikologjike, sociale dhe ekonomike.
- **Të mbështeten programe për dhunuesit**, përmes grupeve të këshillimit, shërbimeve të specializuara dhe terapive.
- **Të intensifikohen fushatat ndërgjegjësuere** për informimin e popullatës për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Aktorët pjesëmarrës në fokus grup sugjerojnë:

- **Zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe informuese në faqen e Bashkisë** për të dhënë informacion për publikun për të gjithë personat specialiste të Ekipit Teknik, që janë në terren dhe punojnë direkt me rastet e dhunës, si dhe ku të përcjellin një mesazh të tyre, për të qenë më pranë viktimave të dhunës;

- **Krijimin e një programi “shërbimi për familjen”**, i cili të trajtojë me shërbim të plotë: psikologjik, ligjor, mundësi trajnimesh dhe punësimi, sipas nevojave për të gjithë anëtarët e familjes ku ka pasur raste dhune dhe që paraqesin vështirësi ekonomike. Kjo ndihmon në fuqizimin e familjes dhe krijimin e një qëndrueshmërie sociale afatgjatë;
- **Hartimin e programeve sociale për menaxhimin e rasteve të dhunës kur përfshihen fëmijët.** Kryesisht këto programe duhet të përfshijnë kategorinë e fëmijëve që janë në famije, ku është raportuar dhunë dhe fëmijët që janë në situatë rruge, që nuk kanë as dokumentacion dhe as strehim;
- **Hartimin e një programi punësimi** për të fuqizuar nga ana ekonomike gratë, të cilat janë pjesë e rasteve të dhunës.



Për Këshillin Bashkiak në Bashkinë Tepelenë.

Nga administrata Bashkisë:

- **Autonomi financiare dhe decentralizim fiskal**, në mënyrë që bashkitë të kenë fondet e mjaftueshme për të siguruar shërbime cilësore dhe të prekshme nga të gjithë qytetarët;
- **Mbështetje financiare për organizimin e më shumë aktiviteteve ndërgjegjësuere** të fokusuara tek edukimi i grave.

Nga pjesëmarrësit në fokus grup sugjerohet:


- **Të mbështeten me projekte punësimi**, veçanërisht gratë;
- **Të alokohet një buxhet i dedikuar në ndihmë të viktimave të dhunës;**
- **Të rritet kualifikimi i stafit profesional** për të ndjekur nga afër rastet e dhunës, për hulumtimin e qëndrimeve sociale dhe kulturore, që pengojnë raportimin e dhunës, si edhe të plotësojnë nevojat e shtetasve, që referojnë se janë dhunuar.

Përgjatë izolimit të pandemisë Covid-19, bashkitë kanë ofruar shërbime për rastet e dhunës në familje të raportuara gjatë kësaj periudhe, po ashtu edhe shërbime për të menaxhuar rastet dhunës në familje të raportuara përpara Covid-19.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport tregojnë se një pjesë e shërbime janë kryer online në rastet kur nuk ka patur nevojë për ndërhyrje emergjente. Të tilla shërbime kanë këshillimi psikologjik, asistenca ligjore dhe dhënia e informacionit sipas kërkesave të rasteve. Gjithashtu, në të shumtën e rasteve edhe mbledhjet e grupeve të punës janë kryer online nëpërmjet platformave elektronike.

Shërbimet kryesore që janë ofruar nga bashkitë, dhe në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, janë shërbime të ndihmës ekonomike, shërbime të strehimit, asistenca ligjore, këshillimi psikologjik, asistenca shëndetësore dhe shërbime të formimit profesional dhe të punësimit.

Bazuar në analizën e të dhënave, nga administrata dhe nga grupet e interesit që ishin pjesë e fokus grupeve, kërkohet që bashkitë dhe këshillat bashkiakë të krijojnë buxhetim të veçantë për shërbimet e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë: ristrukturim të organikës dhe punësim të më shumë psikologëve, punonjësve socialë dhe administratorëve socialë; parashikim të kostove, krijimi i programeve ri-integruese për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë strategji punësimi, aftësim profesional dhe mbështetje financiare; ngritja e qendrave emergjente akomoduese për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe ngritja dhe funksionimi i qendrave multifunksionale dhe qendrave të emergjencës për të trajtuar rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.



ANEKSI 1: FORMAT PERIODIK RAPORTIMI MBI SITUATËN E DHUNËS GJATË SITUATËS COVID-19

RAPORT PERIODIK

Ky raport periodik (një javor) përgatitet nga struktura përgjegjëse në Bashki për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore (Drejtoria e shërbimeve Sociale/Spektori i përfshirjes Sociale, Koordinator vendor i dhunës në familje etj) për interes të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale në Këshillin Bashkiak të Bashkisë X (vendoset emri i bashkisë) me qëllim vlerësimin e situatës së dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore gjatë situatës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19, nevojat e identifikuara dhe marrjen e masave në nivel vendimarrës për adresimin e tyre.

Drejtuar: Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale – Këshilli Bashkiak X

Përgatitur: Z/Znj.XX Koordinator Vendor i Dhunës në Familje

Miratuar: Z/Znj XX, Drejtor/e Shërbimeve Sociale

- Situata e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për periudhën e raportimit në territorin e Bashkisë (përfshirë Njësitë administrative) gjatë pandemisë Covid-19. Ju lutemi plotësoni tabelën në vijim:**

Indikatori	Vlera/Numri
Numri i rasteve të identifikuara për periudhën e raportuar	
Numri i rasteve të vitit të kaluar për të njëjtën periudhë	
Diferenca e raportimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë	
Llojet e shërbimeve të ofruara në kushtet e izolimit (specifiko/rretho shërbimin e ofruar)	- Shërbime të emergjencës (strehëza emergjence) - Transport drejt një mjedisi të sigurtë - Kujdes shëndetësor - Shërbime të mbështetjes psikologjike (online) - Këshillim ligjorë nëpërmjet metodave të arritshme (online) - Shërbime për raportimin e dhunës në situatë emergjence (linja telefonike lokale, media sociale, etj). - Shërbime të formimit profesional dhe punësimit - Programe të strehimit afatgjatë - Programme parandaluese online - Tjetër (Lutemi specifíkoni)_____

2. Informacion mbi llojin e shërbimeve që kanë ofruar gjatë situatës Covid-19 për adresimin e dhunës në familje në territorin e bashkisë:

- Policia e shtetit
- Shërbimet sociale në nivel bashkie
- Shërbimet sociale në nivel Njësie Administrative
- Shërbimet shëndetësore
- Shërbimet arsimore
- Shërbimet e gjygjësorit
- Prokuroria
- Shërbimet e ofruara nga organizatat e shoqërisë civile
- Tjetër (Lutemi specifikoni)_____

3. Informacion mbi funksionimin e Mekanizmit të Kordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje. Situata e bashkepunimit ndër-institucional për ofrimin e shërbimit në kushtet e COVID 19. Ju lutemi në këtë session bëni një përshkrim të funksionimit të MKR gjatë pandemisë.. Nëse ka patur mbledhje të ETN-së për periudhën gjatë pandemisë, si është zhvilluar (mbledhje fizike me antarët e ngushtë duke respektuar rregullat e distancimit fizik/online, etj), cila ka qënë tematika/rastet e trajtuara, etj.

4. Situata e monitorimit të Urdhërave të Mbrojtjes në territor gjatë COVID 19. Ju lutemi në këtë sesion përshkruani si është përmbushur detyrimi ligjor li Kooridnatorit vendor për monitorimin e UM në territor dhe përgatitjen e raportit të monitorimit cdo 60 ditë për çdo rast. Nëse është bërë, a l është vënë në dispozicion policisë ky informacion. Cilat kanë qënë sfidat e ndeshura në këtë proces.

5. Masat që ka marrë ekzekutivi në adresimin e shërbimit ndaj dhunës në familje në kushtet e COVID 19. Ju lutemi në këtë session bëni një përshkrim të masave që ka marrë deri tani ekzekutivi në adresimin e shërbimit, si pasojë e ndryshimeve të legjislacionit, kufizimeve të masave të jashtëzakonshme, rritjes së kërkesës për shërbime (nëse ka).

6. Kostot financiare në ofrimin e shërbimit. Ju lutemi në këtë sesion përshkruani masën e fondit të ofrimit të shërbimit në kushtet e pandemisë.

7. Situata e sigurisë së punonjësve që janë angazhuar në terren për adresimin e e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në kushtet e pandemisë. Ju lutemi në këtë session përshkruani sa punonjës bashkiakë apo ofrues të shërbimit janë të angazhuar në terren (nëse ka) dhe cfarë masash mbrojtëse janë marrë ndaj tyre (maska, doreza), etj.

8. Praktika të mira dhe inovacione në adresimin e dhunës në familje. Ju lutemi në këtë session bëni një përshkrim të praktikave të mira të identifikuar nga drejtoria dhe inovacione të propozuara nga drejtoria për ofrimin e shërbimeve ndaj dhunës në familje.

Konkluzione dhe Rekomandime për Këshillin Bashkiak (KB)/Komisionin e Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale. Ju lutemi në këtë session paraqisni të gjitha nevojat që mund të adresojë KB për një adresim efektiv si alokim/rialokim buxheti për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, ndryshime në numrin e punonjësve/burime njerëzore në administratën e bashkise apo në qendrat e shërbimeve sociale, nderhyrje per permiresimin e bashkepunimit ndër-institucional për ofrimin e shërbimit, nevoja për buxhetimin e shërbimeve/programeve të tjera mbështetëse, në kushtet e pandemisë.

UDHËZUESI I FOKUS GRUPIT ME AKTORËT KYÇ VENDORË

Ky fokus grup zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës së adresimit të dhunës në familje (DHF) dhe dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në nivel vendor.

Qëllimi i fokus grupit lidhet me identifikimin e situatës së adresimit të DHF dhe DHBGJ nën këndvështrimin e aktorëve lokalë dhe do të shërbejë edhe si një mënyrë për të identifikuar qëndrimet, mendimet, opinionet e aktorëve të ndryshëm mbi çështjen si edhe nivelin e bashkëpunimit në mesin e tyre në punën për adresimin e rasteve të dhunës në familje gjatë Covid-19, por edhe post Covid-19.

Të dhënat e gjeneruara mbeten konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllimin e vlerësimit të situatës dhe nevojave për t'u adresuar në fushën e DHF & DHBGJ.

Në vijim gjenden pyetjet/fushat udhërrëfyese për t'u eksploruar gjatë zhvillimit të fokus grupeve apo seancave degjimore me grupet e interesit, siç mund të jenë organizatat e shoqërisë civile në territor për të parë këndvështrimin e tyre mbi punën e bërë, nevojat, sfidat si edhe për të mbledhur rekomandime për një adresim më efektiv të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

1. Prezantimi i pjesëmarrësve.

- Roli dhe shërbimet që ofrojnë për DHF/DHBGJ.
- Eksperienca në adresimin e DHF/DHBGJ.
- Partnerët me të cilët bashkëpunojnë në adresimin e DHF/DHBGJ.

2. Situata e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Bashki

- Si e shikoni situatën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në territorin e Bashkisë tuaj?
- Sipas mendimit tuaj si është paraqitur situata e dhunës në territorin e Bashkisë gjatë pandemisë Covid-19?

3. Shërbimet e ofruara në adresimin e dhunës në familje

- Çfarë mund të thoni lidhur me shërbimet në adresimin e dhunës në familje përgjatë Covid-19?
- Cilat janë shërbimet që ju i vlerësoni që kanë funksionuar më mirë përgjatë Covid-19 në adresimin e dhunës në familje?
- Çfarë mund të thuhet:
 - Për Policinë e Shtetit:
 - Strukturat e shërbimeve sociale:
 - Shërbimet e ofruara nga organizatat:
 - Po për aktorë të tjerë? Media?
- A keni ofruar ju shërbime përgjatë Covid-19?

Nëse po, sa raste keni mbështetur?

4. Cilësia e shërbimeve të ofruara për adresimin e DHF&DHBGJ nga institucionet vendore

- *Si do e vlerësonit cilësinë e shërbimeve sociale të ofruara për adresimin e DHF&DHBGJ nga institucionet vendore (Bashkia/Njësitë administrative) në territorin tuaj?*
- *Çfarë mungon?*
- *Cilat janë aspektet që duhen përmirësuar?*
- *Cilat janë shërbimet që duhet të përmirësohen për një përgjigje më të mirë ndaj dhunës në familje dhe dhunës më bazë gjinore në përballimin e situatave të ngjashme si Covid-19?*
- *Nisur nga eksperiencia gjatë situatës Covid-19, në një situatë tjetër të ngjashme, cilat do të ishin masat/shërbimet që do të duhet të ofroreshin nga institucionet përgjegjëse (MKR) për një adresim më efektiv të dhunës në familje.*
- *Cilat janë praktikatat të mira dhe inovacionet në adresimin e dhunës në familje?*

5. Bashkëpunimi ndërinstitutional

- *Cilët kanë qënë aktorët që janë përfshirë në adresimin e DHF&DHBGJ?*
- *Si e vlerësoni bashkëpunimin ndërinstitutional për adresimin e dhunës në familje në territorin e Bashkisë tuaj gjatë Covid-19?*
- *Cilët janë aktorë të tjerë që mund të përfshihen në adresimin e DHF&DHBGJ?*
- *Sa të përfshirë apo të informuar keni qënë në vendimet e marra nga Bashkia/Këshilli Bashkiak për adresimin e DHF & DHBGJ?*

6. Mekanizimi i Koordinuar i Referimit (MKR)

Nëse bashkia ka të ngritur dhe funksionon Mekanizimi i Koordinuar i Referimit:

- *Si e vlerësoni performancën e Mekanizimit të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në territorin e Bashkisë tuaj përgjatë situatës Covid-19?*

7. Sugjerime

- *Cilat janë sugjerimet/rekomandimet tuaja për një adresim më të mirë të DHF & DHBGJ në territorin e bashkisë?*
- *Cilat janë sugjerimet/rekomandimet tuaja për Këshillin Bashkiak (KB)/Komisionin e Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale për një adresim më të mirë të DHF & DHBGJ?*

Shënime për ekspertin/en:

1. Emër/Mbiemër i *ekspertit/es* _____

2. Bashkia ku u zhvillua fokus grupi: _____

3. Data e zhvillimit të fokus grupit: _____/_____/_____

4. Koha e zhvillimit të fokus grupit: nga ora _____ deri në orën _____

5. Vendi ku zhvillua fokus grupit: _____

6. Shkruani numrin e pjesëmarrësve sipas organizatës/institucionit që përfaqësojnë:

7. Përshtypje të tjera gjatë fokus grupit:
